

**LIGJ**  
**Nr.9917, datë 19.5.2008**

**PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT  
TË TERRORIZMIT**

*(ndryshuar me ligjin nr.10 391, datë 3.3.2011; nr. 66/2012, datë 7.6.2012; nr. 44/2017, datë 6.4.2017; nr. 33/2019, datë 17.6.2019, nr. 120/2021, datë 2.12.2021; nr. 62/2023, datë 21.7.2023; nr. 37/2026, datë 9.4.2026)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**PARIME TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim të parandalojë pastrimin e parave dhe të produkteve që burojnë nga veprat penale, si dhe parandalimin e financimit të terrorizmit.

**Neni 2**  
**Përkufizime**

*(ndryshuar pika 10, 12 dhe shtuar pika 22 me ligjin nr.10 391, datë 3.3.2011; ndryshuar me ligjin nr. 66/2012, datë 7.6.2012; shtuar pika 3/1, shtuar dy fjali në fund të pikës 10, ndryshuar pika 11, shtuar fjali në pikën 12, shtuar fjalia në fund të pikës 13, ndryshuar pika 16 dhe 20, zëvendësuar fjali në pikën 21, shtuar pika 25, 26, 27, 28, 29 dhe 30 me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019; ndryshuar pikat 2, 6, 10, 12, 19, shfuqizuar pika 3.1, shtuat pika 7/1, 10/1, 10/2, ndryshuar fjali në pikat 13, 25, 26, 29 me ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021; ndryshuar emërtim në pikën 1 me ligjin nr. 62/2023, datë 21.7.2023; shtuar pika 4/1 me ligjin nr. 37/2026, datë 9.4.2026)*

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autoritet përgjegjës” është Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF), e cila i raporton drejtpërdrejt Ministrin të Financave dhe shërben si Njësi e Inteligjencës Financiare të Shqipërisë.

2. “Bankë guaskë” është një bankë ose institucion financiar apo një institucion që kryen aktivitete të ngjashme me ato që kryhen nga bankat ose institucionet financiare, e cila, pavarësisht se është themeluar në territorin e një vendi, nuk ka prani fizike në të, si dhe nuk është pjesë e një grupi të rregulluar financiar. Për qëllime të këtij përkufizimi, prania fizike nënkupton ekzistencën e funksioneve drejtuese dhe administruese në territorin e vendit në të cilin është themeluar banka. Ekzistenca vetëm e agjentëve lokalë apo e punonjësve të nivelit të ulët nuk përbën prani fizike.

3. “Bankë korrespondente” është banka që ofron shërbime bankare për llogari të një banke tjetër (banka iniciuese) ose klientëve të saj, të një bankë e tretë (banka pritëse), në bazë të një marrëveshjeje ose marrëdhënieje kontraktuale të lidhur ndërmjet tyre.

3.1 Shfuqizuar.

4. “Financim i terrorizmit” ka të njëjtin kuptim si në nenet 230/a deri në 230/ç të Kodit Penal.

4/1. “Financimi i armëve të dëmtimit në masë” është ofrimi i fondeve apo shërbimeve financiare që përdoren për prodhimin, përvetësimin, posedimin, zhvillimin, eksportin, transportin, transportin ndërmjetësues, ndërmjetësimin, transferimin, grumbullimin apo përdorimin e armëve kimike, biologjike, radiologjike ose bërthamore, mjeteve të dorëzimit të tyre dhe materialeve të lidhura me to.

5. “Instrumente të negociueshme të mbajtësit” përfshijnë instrumentet monetare në formën e mbajtësit në pronësi të këtij të fundit, të tilla si çeqet e udhëtarit; instrumentet e negociueshme (ku përfshihen, por pa u kufizuar në çeqet, premtimpagesat dhe urdhërpagesat), që janë në formën e mbajtësit, të vlefshme, pa u kufizuar nga personi të cilit i paguhet, të paguara një personi fiktiv ose përndryshe në një formë që pronësia kalohet thjesht nëpërmjet dorëzimit nga një person të një tjetër; instrumentet jo të plota (përfshirë, por pa u kufizuar në çeqet, premtimpagesat dhe urdhërpagesat), të nënshkruara, por pa përfshirë emrin e personit të cilit i paguhet.

6. “Klient” është personi i cili është përdorues i shërbimeve të ofruara nga subjektet e nenit 3 të këtij ligji.

7. “Marrëdhënie biznesi” është çdo marrëdhënie profesionale ose tregtare, e cila lidhet me veprimtaritë e ushtruara nga subjektet e këtij ligji dhe klientët e tyre, që, në çastin e vendosjes së saj, vlerësohet të jetë një marrëdhënie e vazhdueshme.

7/1. “Marrëdhënie korrespondente” është:

a) ofrimi i shërbimeve bankare nga një bankë si korrespondente të një bankë tjetër si pritëse, duke përfshirë ofrimin e shërbimeve të llogarisë rrjedhëse apo të llogarive të tjera të detyrimit dhe të shërbimeve të ndërlidhura, si: administrimi i parave, transferimi ndërkombëtar i fondeve, klerimi/shlyerja e çeqeve, llogaritë për pagesa dhe shërbimet e këmbimit valutor;

b) marrëdhënia ndërmjet bankave dhe institucioneve financiare, duke përfshirë rastet kur shërbimet e ngjashme ofrohen nga një institucion korrespondent të një institucion pritës, duke përfshirë marrëdhëniet e krijuara për transaksionet e titujve apo transferimin e fondeve.

8. “Para fizike” janë monedhat (kartëmonedhat dhe monedhat metalike, kombëtare dhe të huaja) në qarkullim.

9. “Pastrim i produkteve të veprës penale” ka të njëjtin kuptim si në nenin 287 të Kodit Penal.

10. “Personat e ekspozuar politikisht” në kuptim të këtij ligji janë:

a) individët, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarinë e pasurive të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi për deklarinë dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë, me përjashtim të nëpunësve të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues, pavarësisht nëse kanë detyrimin për deklarinë sipas legjislacionit në fuqi për deklarinë dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë;

b) individët, të cilët kanë ose kanë pasur funksione të rëndësishme si brenda vendit apo jashtë vendit në një qeveri dhe/ose në një shtet të huaj, të tillë si: kryetar shteti dhe/ose qeverie, ministra, zëvendësministra ose pozicione të ngjashme me to, anëtarë të Kuvendit ose organeve legjislativë të ngjashme, politikanë të lartë, anëtarë të organeve drejtuese të partive politike, gjyqtarët e gjykatave të larta ose kushtetuese, si dhe çdo gjyqtar i një gjykate, ndaj

vendimeve të së cilës nuk mund të ushtrohen mjetet e zakonshme të ankimit, anëtarët e organeve drejtuese të bankave qendrore, ambasadorët dhe të ngarkuarit me punë, si dhe oficerët me gradë madhore në Forcat e Armatosura, drejtuesit e lartë dhe/ose anëtarët e organeve drejtuese të shoqërive shtetërore, si dhe drejtorët, zëvendësdrejtorët ose anëtarët e bordit ose çdo pozicion tjetër i ngjashëm me to në një organizatë ndërkombëtare.

Individët e përcaktuar në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike do të konsiderohen “persona të ekspozuar politikisht” deri në 3 (tre) vjet pas largimit nga funksioni.

10/1. Anëtarët e familjes së personit të ekspozuar politikisht janë:

- a) bashkëshorti/ja apo bashkëjetuesi/ja e një personi të ekspozuar politikisht;
- b) fëmijët dhe bashkëshortët/et e tyre apo bashkëjetuesit/set e një personi të ekspozuar politikisht;
- c) prindërit e një personi të ekspozuar politikisht.

10/2. Persona të lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, pune ose biznesi të personit të ekspozuar politikisht për qëllime të këtij ligji janë:

a) individët që janë bashkërisht pronarë përfitues në persona juridikë ose organizime ligjore apo çfarëdo marrëdhënie tjetër të ngushtë biznesi me një person të ekspozuar politikisht;

b) personat të cilët janë pronarët përfitues të vetëm një personi juridik apo organizimi ligjor, i cili dihet se është krijuar për përfitim de-facto të personit të ekspozuar politikisht.

11. Produkt i veprës penale” është çdo pasuri e rrjedhur ose e përfiturar, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga një veprë penale apo veprimtarie kriminale.

12. “Pronar përfitues” ka të njëjtin kuptim si në legjislacionin në fuqi për Regjistrin e Pronarëve Përfitues.

13. “Pasuri” janë të drejta apo interesa pasurore të çdo lloji mbi një aset, qoftë ky i luajtshëm ose i paluajtshëm, i trupëzuar ose i patrupëzuar, material ose jomaterial, përfshirë dhe ato të evidentuara në formë elektronike apo numerike (digjitale), duke përfshirë, por pa u kufizuar në instrumente të tilla si kreditë, çeket e udhëtimit, çeket bankare, urdhërpagesat, të gjitha llojet e titujve, mandatpagesat dhe letrat e kreditit, si dhe çdo interes, dividend, e ardhur apo vlerë tjetër që buron prej tyre. Në kuptim të këtij ligji, fjala “fond” ka të njëjtin kuptim si pronësi.

14. “Subjekt” është personi fizik ose juridik që vendos marrëdhënie biznesi me klientë, gjatë veprimtarisë së tij normale apo si pjesë e veprimtarisë tregtare ose profesionale të tij.

15. “Shërbim i transfertës së parasë ose vlerës” është kryerja e biznesit për të pranuar para fizike ose mjete apo instrumente të tjera të tregut të parasë dhe/ose të pagesave (çeqe, dëftesa, certifikata të depozitave, kartat e debitit ose të kreditit, kartat elektronike të pagesave etj.), titujt, si dhe çdo dokument tjetër që vërteton ekzistencën e një detyrimi monetar ose një vlere tjetër të depozituar dhe për t’i paguar përfituesit një shumë korresponduese në para fizike, ose në një formë tjetër, me anë të komunikimit, mesazhit, transferimit ose përmes sistemit të kleringut apo të shlyerjes, të cilit i përket shërbimi i transfertës së parasë ose vlerës.

16. “Transaksion” është një shkëmbim dhe/ose ndërveprim, që përfshin dy ose më shumë palë, apo një veprim i kërkuar nga klienti për llogari të tij pa përfshirjen e palëve të tjera.

17. “Transaksione të lidhura me njëri-tjetrin” janë dy ose më shumë transaksione (duke përfshirë transfertat e drejtpërdrejta), ku secila prej tyre është më i vogël se sa shuma e përcaktuar si prag, në bazë të nenit 4 të këtij ligji dhe kur këto transaksione në shumë totale barazojnë ose tejkalojnë shumën e pragut të zbatueshëm.

18. “Transfertë e drejtpërdrejtë elektronike” është çdo transaksion i kryer në emër të një personi të parë mandatues (fizik ose juridik) përmes një institucioni financiar, nëpërmjet mjeteve elektronike apo telegrafike, për vënien në dispozicion të një shume të caktuar parash

ose instrumentesh të tjera të tregut të parasë ose pagesave, për një person përfitues në një institucion tjetër financiar. Mandatuesi e përfituesi mund të jenë i njëjti person.

19. “Trust” është marrëdhënia ligjore midis të gjallëve apo për shkak të vdekjes, me të cilën një person, themeluesi, vendos asete nën kontrollin e një kujdestari për llogari të një përfituesi apo për një qëllim të posaçëm. Trusti ka karakteristikat e mëposhtme:

- a) asetet formojnë një zë të ndarë dhe nuk përfshihen në pasurinë e kujdestarit;
- b) titulli i aseteve të trustit mbahet nga kujdestari ose nga një person tjetër për llogari të kujdestarit;
- c) kujdestari ka të drejtën dhe detyrën për të kryer me përgjegjshmëri administrimin, përdorimin dhe disponimin e aseteve në përputhje me kushtet e trustit dhe detyrimet e posaçme të parashikuara me ligj.

19/1 “Vigjilenca e duhur” është tërësia e masave që duhet të aplikojnë subjektet, me qëllim identifikimin dhe verifikimin e plotë dhe të saktë të klientëve, pronarit përfitues përfundimtar, strukturës së pronësisë dhe të kontrollit për personat juridikë dhe organizimet ligjore, natyrën dhe qëllimin e transaksionit apo marrëdhënies, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit dhe të shqyrtimit të vazhdueshëm të transaksioneve, për të siguruar që janë në përputhje me natyrën e biznesit të klientit dhe profilet e rrezikut, duke përfshirë, kur është e nevojshme, burimin e fondeve.

20. “Vigjilencë e zgjeruar ndaj klientit” është një proces më i thellë kontrolli, përtej procedurave “Njihe klientin tënd”, si dhe masave të “Vigjilencës së duhur”, që synon të krijojë sigurinë e mjaftueshme për të verifikuar dhe vlerësuar:

- a) identitetin e klientit;
- b) për të kuptuar dhe testuar profilin e klientit, të biznesit dhe veprimtarisë së tij lidhur me shërbimet, produktet dhe transaksionet e ofruara nga subjekti;
- c) për të identifikuar informacionet me rëndësi dhe për të vlerësuar rrezikun e mundshëm për pastrim parash/financim terrorizmi, në mbështetje të vendimeve që synojnë mbrojtjen nga rreziqet financiare, rregullatore apo reputacionale, si dhe përshtatjen ndaj kërkesave ligjore.

21. “Procedura njihe klientin tënd” nënkupton një sërë rregullash, të përdorura nga subjektet e këtij ligji, që kanë të bëjnë me politikat e pranimit e të identifikimit të klientit dhe administrimit të riskut të tyre.

22. “Person”, në kuptim të këtij ligji, konsiderohen individët, personat fizikë tregtarë dhe personat juridikë.

23. “Llogari transitore” është llogaria korrespondente që përdoret në mënyrë të drejtpërdrejtë nga palët e treta për të kryer transaksione biznesi në emër të tyre.

24. “Organizime ligjore” janë trustet apo marrëveshjet e tjera të ngjashme.

25. “Mjet virtual” është një pasqyrim digjital i një vlere që mund të depozitohet, të tregtohet apo të transferohet në formë digjitale, si dhe që mund të përdoret për qëllime pagesash ose investimesh, apo si mjet shkëmbimi, duke përfshirë por pa u kufizuar te kriptomonedha. Në këtë përkufizim nuk përfshihen pasqyrimet digjitale të monedhave të njohura zyrtarisht si të nxjerra ose të garantuara nga bankat qendrore ose një autoritet publik, të letrave me vlerë dhe mjeteve të tjera financiare që janë parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

26. “Ofrues i shërbimeve të mjeteve virtuale” nënkupton çdo person fizik ose juridik, i cili kryen, për ose në emër të një personi tjetër fizik ose juridik, një ose më shumë nga këto aktivitete:

- i) shkëmbimi ndërmjet mjeteve virtuale dhe monedhave të njohura zyrtarisht;
- ii) shkëmbimi ndërmjet mjeteve virtuale dhe pasurive të çdo lloji me vlerë mbi 1 000 000 (një milion) lekë;

- iii) shkëmbimi ndërmjet një ose më shumë formave të mjeteve virtuale;
- iv) transferimi i mjeteve virtuale;
- v) ruajtja dhe/ose administrimi i mjeteve virtuale ose instrumenteve që mundësojnë kontroll mbi mjetet virtuale;
- vi) pjesëmarrja dhe sigurimi i shërbimeve financiare lidhur me ofertën e një emetuesi dhe/ose shitjen e një mjeti virtual.

Në kuptim të kësaj pike, transferimi nënkupton kryerjen e transaksionit për llogari të një personi tjetër fizik apo juridik, që lëviz mjetin virtual nga adresa e mjetit virtual ose llogaria e një personi tjetër.

27. “Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar” është një organ ndërqeveritar, përgjegjësia e të cilit është të përcaktojë standardet e të nxisë zbatimin efektiv të masave ligjore, rregullative dhe operacionale për luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë e kërcënime të tjera që lidhen me integritetin e sistemit financiar ndërkombëtar.

28. “Palë e tretë”, në kuptim të këtij ligji, nënkupton subjekt të mbikëqyrur nga autoritetet kompetente, detyrimisht të regjistruar në Shqipëri, në një nga shtetet anëtare të Bashkimit Europian apo shtete të treta, me kusht që të plotësojnë kushtet si më poshtë:

a) të jenë të rregulluara me ligj të posaçëm dhe të detyruara për t’u regjistruar në vendin përkatës; si dhe

b) të jenë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, shtetet anëtare të Bashkimit Europian ose në një vend të tretë, me kusht që të zbatojnë kërkesa të njëjta ose më të larta me ato të vendosura nga ky ligj për vigjilencën e duhur dhe të zgjeruar, identifikimin e klientit dhe të pronarit përfitues, ruajtjen e informacionit, si dhe të mbikëqyren nga autoritetet kompetente për përputhshmërinë për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit.

29. “Kujdestar” është personi, i cili është ligjërisht i autorizuar të kontrollojë dhe të administrojë fonde apo pasuri të një organizimi ligjor për llogari të një pale të tretë.

30. “Vigjilencë e thjeshtuar” është një tërësi masash që zbatohet nga subjektet e ligjit për vendosjen dhe monitorimin e marrëdhënies së biznesit me klientët, produktet dhe shërbimet e ofruara, të cilët paraqesin një nivel të ulët risku për pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit.

### Neni 3

#### **Subjektet që i nënshtrohen këtij ligji**

*(ndryshuar me ligjin nr.10 391, datë 3.3.2011; nr. 66/2012, datë 7.6.2012; ndryshuar shkronjat “g”, “j” “k”, shtuar shkronjat “l” dhe “ll” me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019; ndryshuar fjalë në shkronjën “e”, ndryshuar shkronja “g”, shtuar fjalë në shkronjën “b”, hiqen fjalë në nënndarjen “v” të shkronjës “k”, shtuar nënndarjet “v/1” dhe “v/2”, të shkronjës “k”, shtuar shkronjat “m”, “n” me ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021; ndryshuar nëndarja “v” e shkronjës “ll” me ligjin nr. 37/2026, datë 9.4.2026)*

Subjekte të këtij ligji janë:

- a) subjektet bankare, si dhe çdo subjekt tjetër që licencohet apo mbikëqyret nga Banka e Shqipërisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në subjektet e parashikuara në shkronjat “b”, “c” e “ç” të këtij neni.
- b) subjektet financiare jobanka;
- c) zyrat e këmbimeve valutore;
- ç) shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre;
- d) shërbimet postare që kryejnë shërbime pagesash;

- dh) Shfuqizuar;
- e) bursat dhe çdo subjekt tjetër (agjent, broker, shoqëri komisionere etj.), që ushtron veprimtari për emetimin, këshillimin, ndërmjetësimin, financimin dhe çdo shërbim tjetër që ka lidhje me tregtimin e titujve;
- ë) shoqëritë që merren me sigurimin e jetës ose risigurimin, agjentët apo ndërmjetësit e tyre, si dhe fondet e pensionit;
- f) Autoriteti Shtetëror Përgjegjës për Administrimin dhe Shitjen e Pronës Publike dhe çdo person tjetër juridik publik që kryen veprime juridike lidhur me tjetërsimin dhe dhënien në përdorim të pronës shtetërore, ose që kryen evidentimin, transferimin apo tjetërsimin e pronës shtetërore;
- gj) avokatët, noterët dhe profesionet e tjera, kur përgatisin transaksione ose kur marrin pjesë duke vepruar në emër dhe për llogari të klientit të tyre në çfarëdo transaksioni financiar apo të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme ose duke ndihmuar në planifikimin dhe kryerjen e transaksioneve për klientët e tyre, apo kryejnë veprime të tjera që mund të rezultojnë si mbështetje për përcaktimin e vlerës së kuotave të pronësisë apo për kryerjen e transaksioneve të mëposhtme:
- i. kalimin e pronësisë së pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, administrimin e parave, të titujve ose të aseteve të tjera;
  - ii. hapjen ose administrimin e llogarive bankare, të kursimeve apo të kasetave të sigurisë;
  - iii. administrimin e pjesëve të kapitalit që do të përdoren për themelimin, funksionimin ose administrimin e shoqërive tregtare;
  - iv. krijimin, funksionimin, blerjen, shitjen ose administrimin e personave juridikë dhe/ose organizimeve ligjore;
  - v. marrëveshjet ligjore, shitblerjen e aksioneve ose të pjesëve të kapitalit të shoqërive aksionare dhe transferimin e veprimtarive tregtare, rritjet apo pakësimet e kapitalit, përcaktimin e pjesëve;
  - vi. aktet që lidhen me njohjen ose shlyerjen e detyrimeve ndërmjet personave.
- gj) avokatët, noterët dhe përfaqësuesit e tjerë ligjorë, audituesit ligjorë, kontabilistët e miratuar dhe profesionet e tjera të rregulluara kur përgatisin transaksione ose kryejnë shërbime për klientët e tyre për veprimtaritë e mëposhtme:
- i) kalimin e pronësisë së pasurive të paluajtshme, administrimin e parave, të letrave me vlerë ose të aseteve të tjera;
  - ii) administrimin e llogarive bankare;
  - iii) administrimin e pjesëve të kapitalit që do të përdoren për themelimin, funksionimin ose administrimin e shoqërive tregtare;
  - iv) krijimin, funksionimin ose administrimin e personave juridikë dhe/ose organizimeve ligjore;
  - v) marrëveshjet ligjore, shitblerjen e aksioneve ose të pjesëve të kapitalit të shoqërive aksionare dhe transferimin e veprimtarive tregtare;
- h) agjentët e pasurive të paluajtshme, sipas kuptimit të përcaktuar në legjislacionin shqiptar për këtë kategori, kur përfshihen në transaksione për klientët e tyre, që lidhen me blerje ose shitje të pasurive të paluajtshme apo kur veprojnë si ndërmjetës në dhënien me qira të pasurive të paluajtshme në lidhje me transaksionet për të cilat qiraja mujore arrin në vlerën e barabartë apo më të madhe se 500 000 (pesëqind mijë) lekë, pavarësisht nëse transaksioni kryhet në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione të lidhura.
- i) Shfuqizuar;
  - j) shoqëritë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe të fondeve të

pensioneve, si dhe agjentët e tyre;

k) çdo person fizik ose juridik, përveç atyre të specifikuar më sipër, të cilët merren me:  
i) administrimin e aseteve të të tretëve dhe/ose drejtimin e veprimtarive të lidhura me to;

ii) ndërtimet;

iii) biznesin e metaleve e të gurëve të çmuar;

iv) marrëveshjet e garancitë financiare;

v) shitblerjen me ankand të sendeve me vlerë 1 000 000 (një milion) lekë ose më shumë;

v/1. shitblerjen apo ndërmjetësimin e veprave të artit, përfshirë kur kjo kryhet nga galeritë e artit apo shtëpitë e ankandeve, kur vlera e transaksionit të vetëm apo e transaksioneve të lidhura me njëra-tjetrën është e barabartë apo më e madhe se 1 000 000 (një milion) lekë, pavarësisht nëse transaksioni kryhet në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione të lidhura me njëra-tjetrën;

v/2. magazinimin, shitblerjen apo ndërmjetësimin e veprave të artit, kur kjo kryhet në “zonat e lira”, kur vlera e transaksionit të vetëm apo e transaksioneve të lidhura me njëra-tjetrën është e barabartë apo më e madhe se 1 000 000 (një milion) lekë, pavarësisht nëse transaksioni kryhet në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione të lidhura me njëra-tjetrën.

vi) sigurimin dhe administrimin e parasë fizike ose titujve lehtësisht të konvertueshëm, në emër të personave të tretë;

vii) veprimtaritë e spedicionit dhe/ose të transportit;

viii) tregtimin e mjeteve motorike tokësore, lundruese dhe ajrore;

ix) agjencitë e udhëtimit;

l) çdo person fizik ose juridik, i cili merret me ofrimin e shërbimeve të mjeteve virtuale;

ll) çdo person fizik ose juridik, përveç atyre të specifikuar më sipër, të cilët ofrojnë për një klient shërbimet si më poshtë:

i) vepron si agjent formimi i personave juridikë;

ii) vepron ose cakton dikë tjetër të veprorë si një drejtor ose administrator i një personi juridik, pjesëtar i një ortakërie apo një pozitë të ngjashme lidhur me persona të tjerë juridikë;

iii) siguron një zyrë të regjistruar, akomodim ose adresë për biznesin, adresë zyrtare ose me korrespondencë për një shoqëri tregtare, partneritet, person juridik apo organizime ligjore;

iv) vepron ose cakton dikë tjetër të veprorë si i besuar i një organizimi ligjor ose kryen funksionin ekuivalent për një formë tjetër organizimi ligjor;

v) vepron ose cakton dikë tjetër të veprorë si një aksionar përfaqësues për një person tjetër;

m) çdo individ, person fizik apo juridik, që tregton mallra apo shërbime në masën që kryen apo pranon pagesa në para fizike në një shumë prej 1 000 000 (një milion) lekësh ose më shumë, pavarësisht nëse transaksioni kryhet në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione të lidhura;

n) audituesit ligjorë, kontabilistët e miratuar, këshilltarët tatimorë, si dhe çdo person tjetër që merr përsipër të ofrojë drejtpërdrejt apo nëpërmjet personave të tjerë me të cilët ai person ka lidhje ndihmë materiale, asistencë apo këshillim për çështje tatimore, si biznes kryesor apo veprimtari profesionale.

Neni 3/1

### **Detyrimet e organizimeve ligjore**

*(shtuar me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019; ndryshuar fjalë në pikën 2 dhe shtuar pika 4 me ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021)*

1. Kujdestarët e organizimeve ligjore janë të detyruar të deklarojnë statusin e tyre e të vënë në dispozicion informacionin e kërkuar nga subjektet e këtij ligji kur vendosin një marrëdhënie biznesi me to apo kur kryejnë transaksione rastësore.

2. Kujdestarët e organizimeve ligjore duhet të mbajnë informacion thelbësor për themeluesit, përfituesit, kujdestarët ose personat me një kontroll faktik mbi to, agjentët e tjerë të rregulluar dhe ofruesit e shërbimeve, përfshirë këshilltarët, menaxherët, kontabilistët dhe këshilltarët tatimorë/fiskalë.

3. Përveç detyrimeve që kanë si subjekte të ligjit, organizimet ligjore duhet të mbajnë informacion të saktë, të përshtatshëm, të vlefshëm dhe të përditësuar për sa parashikohet në këtë nen.

4. Personi përgjegjës për zbatimin e detyrimeve të organizimeve ligjore që rrjedhin nga ky ligj është kujdestari i këtyre organizimeve.

## KREU II VIGJILENCA E DUHUR

### Neni 4

#### **Rastet kur kërkohet vigjilenca e duhur**

*(ndryshuar shkronja “b”, nënndarja “i” e pikës 1 dhe pika 2 me ligjin nr.10 391, datë 3.3.2011 dhe nr. 66/2012, datë 7.6.2012; zëvendësuar shprehje në shkronjën “b”, nënndarja “i” me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019; shtuar fjalë në shkronjën “c” me ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021; ndryshuar shkronja “ç” me ligjin nr. 37/2026, datë 9.4.2026)*

Subjektet duhet të marrin masat e vigjilencës së duhur ndaj klientit në rastet e mëposhtme:

a) para se të vendosin një marrëdhënie biznesi;  
b) kur klienti, në raste të ndryshme nga ato të përcaktuara në shkronjën “a” të kësaj pike, kryen ose kërkon të kryejë:

i) një transfertë brenda ose jashtë vendit apo një transaksion në një shumë të barabartë ose më të madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të huaja, për subjektet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “g” dhe “l” të nenit 3 të këtij ligji, si dhe subjektet e tjera që kryejnë shërbime transfertash, këmbimi valutor apo lojëra fati;

ii) një transaksion me një shumë të barabartë me jo më pak se 1 000 000 (një milion) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja, kryer në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione të lidhura me njëri-tjetrin. Nëse shuma e transaksioneve nuk dihet në kohën e veprimit, identifikimi duhet të kryhet sapo të bëhet e ditur shuma dhe të arrihet pragu i mësipërm;

c) kur ka dyshime për vërtetësinë ose përshtatshmërinë e të dhënave të identifikimit të marra më parë;

ç) në të gjitha rastet, pavarësisht nga limitet e raportimit, të parashikuara në këtë nen, kur ka dyshime për pastrim parash, financim të terrorizmit apo financim të armëve të dëmtimit në masë.

Neni 4/1

### **Masat e vigjencës së duhur**

*(shtuar me ligjin nr. 66/2012, datë 7.6.2012; shtuar fjali në fund të shkronjës “dh”, shtuar fjalë dhe ndryshuar nënndarjet “ii” dhe “iii” të shkronjës “g”, shtuar pika 1/1, zëvendësuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019; shtuar nënndarja “iii” në pikën 1, shtuar shkronja “b/1” dhe ndryshuar shkronja “dh” me ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021)*

1. Në kuadrin e ushtrimit të vigjencës së duhur ndaj klientit, subjektet duhet:

a) të identifikojnë klientin (të përherëshëm apo rastësor, person fizik, juridik apo organizime ligjore) dhe të verifikojnë identitetin e tij nëpërmjet dokumenteve, të dhënave apo informacioneve të marra nga burime të besueshme dhe të pavarura;

b) për klientët që janë persona juridikë ose organizimet ligjore:

i) të verifikojnë nëse çdo person që vepron në emër të klientit të tij është i autorizuar dhe të identifikojnë dhe të verifikojnë identitetin e tij;

ii) të verifikojnë statusin e tyre ligjor, nëpërmjet dokumenteve të themelimit, të regjistrimit ose fakteve të ngjashme të ekzistencës së tyre, si dhe të sigurojnë informacion për emrin e klientit, emrat e të mirëbesuarve (për organizimet ligjore), formën ligjore, adresën, drejtuesit dhe/ose përfaqësuesit ligjorë (për personat juridikë) dhe dispozitat që rregullojnë marrëdhëniet juridike;

iii. në rastin e përfituesve të trusteve ose organizimeve ligjore, të përcaktuara në bazë të karakteristikave të veçanta apo klasës, duhet të marrin informacion të mjaftueshëm rreth përfituesit në mënyrë që të garantohet identifikimi i përfituesit në momentin e kryerjes së pagesës apo të ushtrimit të të drejtave nga përfituesi.

b/1) për sigurimin e jetës apo sigurimet e tjera të lidhura me investimet, përveç ushtrimit të detyrueshëm të masave që duhet të ndërmerren për ushtrimin e vigjencës së duhur ndaj klientit dhe pronarit përfitues, subjektet marrin masat e mëposhtme ndaj përfituesit të sigurimit të jetës dhe policave të tjera të sigurimit të lidhura me investimet, sapo përfituesi/sit identifikohet/en apo përcaktohet/en:

i. në rast të përfituesve të identifikuar si persona të emëruar specifikisht apo në rastin e organizimeve ligjore, merren të dhënat për identifikimin e personit;

ii. në rastin e përfituesve të përcaktuar në bazë të karakteristikave, klasës apo nga mjete të tjera, banka ose institucioni financiar duhet të marrë informacion të mjaftueshëm në lidhje me përfituesin/sit për të përcaktuar identitetin e përfituesit në kohën e pagesës.

Në lidhje me nënndarjet “i” dhe “ii”, verifikimi i identitetit të përfituesve do të bëhet në momentin e kryerjes së pagesës. Në rastin e kryerjes tërësisht ose pjesërisht të sigurimit të jetës ose të investimeve në dobi të një pale të tretë, subjektet në dijeni të caktimit të një pale të tretë duhet të identifikojnë pronarin përfitues në kohën e caktimit të personit fizik, të personit juridik apo të organizimit ligjor që përfiton nga policat e sigurimit.

c) të identifikojnë pronarin përfitues dhe të marrin masa të arsyeshme për të verifikuar identitetin e tij, nëpërmjet informacioneve ose të dhënave të siguruar nga burime të besueshme, në bazë të të cilave subjekti sigurohet për identitetin e tij;

ç) të përcaktojnë për të gjithë klientët, para vendosjes së marrëdhënieve të biznesit, nëse ata janë duke vepruar në emër të një personi tjetër, dhe të marrin masa të arsyeshme për të siguruar të dhëna të mjaftueshme për identifikimin dhe verifikimin e atij personi;

d) të kuptojnë strukturën e pronësisë dhe kontrollit për klientët që janë persona juridikë apo organizimet ligjore;

dh) të përcaktojnë se cilët janë individët që zotërojnë ose kontrollojnë klientin, përfshirë ata persona të cilët ushtrojnë kontrollin e fundit efektiv mbi personin juridik apo

organizimin ligjor. Për personat juridikë kjo duhet të përfshijë edhe identifikimin e individëve, të cilët përbëjnë pjesën vendimmarrëse dhe administruese të personit juridik dhe mbajtjen e të dhënave të veprimeve të ndërmarra, si dhe të çdo vështirësie të hasur gjatë procesit të verifikimit. Në rast të organizimeve ligjore, kjo përfshin edhe identifikimin e themeluesit, të përfituesit, të kujdestarit ose të personit me një kontroll faktik mbi to;

e) të mbledhin informacion për qëllimin dhe natyrën e marrëdhënies së biznesit dhe të zhvillojnë profilin e riskut gjatë monitorimit të vazhdueshëm;

ë) të kryejnë monitorim të vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me klientin, përfshirë analizimin e transaksioneve të kryera gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj marrëdhënieje, për t'u siguruar se ato janë në përputhje me njohuritë që subjekti ka për klientin, natyrën e biznesit të tij, profilin e riskut, si dhe burimin e fondeve;

f) të sigurohen, nëpërmjet rishikimit të dosjeve të klientëve, që dokumentet, të dhënat dhe informacioni i mbledhur gjatë procesit të vigjilencës së duhur janë përditësuar, janë të vlefshme dhe të përshtatshme, veçanërisht për klientët apo marrëdhëniet e biznesit që kategorizohen me risk të lartë;

g) të verifikojnë identitetin e klientit dhe pronarit përfitues përpara ose gjatë vendosjes së marrëdhënies së biznesit ose kryerjes së një transaksioni për klientët rastësorë. Verifikimi i identitetit të klientit dhe pronarit përfitues mund të kryhet pas vendosjes së marrëdhënies së biznesit, me kusht që verifikimi:

i) të realizohet sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur;

ii) të mos çojë në ndërprerjen e aktivitetit normal të zhvillimit të biznesit; dhe

iii) rreziqet e pastrimit të parave e financimit të terrorizmit të menaxhohen në mënyrë efektive në përputhje me masat e përcaktuara në këtë nen.

g) të përcaktojnë procedurat e menaxhimit të riskut që do të zbatohen për rastet kur një klient mund të lejohet të përdorë marrëdhënien e biznesit përpara ose gjatë plotësimit të procesit të verifikimit.

Këto procedura, ndër të tjera, duhet të përfshijnë masa për kufizimin e numrit, të llojit dhe/ose të shumës së transaksioneve që mund të kryhen, si dhe monitorimin e transaksioneve, në vlera të larta apo komplekse, të kryera jashtë profilit të pritshëm për veçoritë e kësaj marrëdhënieje;

h) të plotësojnë detyrimet e sipërpërmendura edhe për klientët ekzistues, duke u bazuar në prova, fakte dhe rrezikun e ekspozimit ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

1/1. Subjektet verifikojnë se çdo person që pretendon të veprojë në emër të klientit të tyre është i autorizuar për veprimet e kërkuara, si dhe të identifikojë e të verifikojë identitetin e personit të autorizuar.

2. Kur subjektet janë të paafta që të plotësojnë detyrimet për vigjilencën e duhur ndaj klientit, sipas këtij neni dhe neneve 4, 4/1 e 5 të këtij ligji, duhet:

a) të mos hapin llogari, të mos kryejnë transaksione dhe të mos fillojnë marrëdhënie biznesi;

b) nëse ka filluar marrëdhënia e biznesit, ta ndërpresin atë;

c) t'i dërgojnë raport për aktivitet të dyshimtë “autoritetit përgjegjës”;

ç) të mos hapin apo të mos mbajnë llogari anonime, me emra fiktivë ose të identifikuar vetëm nëpërmjet një numri apo kodi, përfshirë depozitat apo instrumentet e tjera të mbajtësit. Nëse ka llogari të tilla, klientët e tyre duhet të identifikohen dhe të verifikohen, sipas parashikimeve të këtij neni. Nëse kjo nuk arrihet, llogaria duhet të mbyllet dhe t'i dërgohet raport për aktivitet të dyshimtë “autoritetit përgjegjës”.

## Neni 4/2

### **Vigjilenca e thjeshtuar**

*(shtuar me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019)*

1. Vigjilenca e thjeshtuar ndaj klientëve mund të kryhet në rastet kur identifikohet rrezik i ulët për pastrim parash dhe/ose financim të terrorizmit, bazuar në vlerësimet e riskut të autoriteteve të ngarkuara me ligj, si dhe vlerësimet e rrezikut dhe të procedurave të menaxhimit të përcaktuara nga vetë subjektet e ligjit. Në vlerësimin e rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, që lidhen me llojin e klientëve, zonës gjeografike, produkteve, shërbimeve, transaksioneve apo kanaleve të veçanta të shpërndarjes, subjektet e këtij ligji marrin parasysh faktorët dhe situatat e parashikuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Gjatë zbatimit të vigjilencës së thjeshtuar, subjektet mund:

i) të ulin frekuencën e përditësimit të të dhënave për procesin e identifikimit, si dhe shkallën e monitorimit të vazhdueshëm;

ii) të mos mbledhin informacion specifik apo të ndërmarrin masa specifike për të kuptuar qëllimin dhe natyrën e marrëdhënies së biznesit në çdo rast, por mund ta përcaktojnë këtë në bazë të marrëdhënies së biznesit të vendosur.

3. Vigjilenca e thjeshtuar e klientit mund të kryhet vetëm kur monitorimi i marrëdhënieve të biznesit të klientit vazhdon të kryhet gjatë ose pas vigjilencës së thjeshtuar të klientit dhe ekziston mundësia për të identifikuar transaksionet e pazakonta apo të dyshimta.

4. Në rast se, gjatë kryerjes së monitorimit të vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me klientin, vlerësohet apo ka element për të besuar se nuk është më i ulët rreziku i pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, veprave penale ose veprimtarive kriminale që gjenerojnë produkte të veprës penale, subjektet janë të detyruara të marrin masat e plota për zbatimin e vigjilencës së duhur në përputhje me nenin 4/1 të këtij ligji.

5. Vigjilenca e thjeshtuar nuk mund të zbatohet në rastet kur ka dyshime për pastrim parash, financim terrorizmi, vepra penale ose veprimtari kriminale që gjenerojnë produkte të veprës penale, si dhe kur zbatohet vigjilenca e zgjeruar apo skenarë specifike rrisht të lartë.

6. Ndalohet kryerja e vigjilencës së thjeshtuar ndaj kategorive të klientëve kur kjo vendoset nga autoriteti përgjegjës.

## Neni 5

### **Dokumentacioni i kërkuar për identifikimin e klientit**

*(ndryshuar pika 1, shtuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019; shtuar pika 2/1 me ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021; ndryshuar togfjalësh në pikën 2/1 me ligjin nr. 62/2023, datë 21.7.2023)*

1. Për identifikimin dhe verifikimin e identitetit të klientit, subjektet duhet të regjistrojnë e të mbajnë të dhënat si më poshtë:

a) për personat fizikë: emrin, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, shtetësinë, vendbanimin e përkohshëm (nëse ka) dhe të përhershëm, punësimin, llojin dhe numrin e dokumentit të identifikimit, numrin personal për shtetasit e Republikës së Shqipërisë, si dhe atë të barasvlershëm për shtetasit e huaj, autoritetin që e ka lëshuar, si dhe të gjitha ndryshimet e bëra në çastin e kryerjes së transaksionit.

b) për personat fizikë, që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse: emrin, mbiemrin, datën e vendimit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dokumentin që vërteton objektin

e veprimtarisë, numrin unik të identifikimit të subjektit, adresën dhe të gjitha ndryshimet e bëra në çastin e kryerjes së transaksionit;

c) për personat juridikë privatë, që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse: emrin, datën e vendimit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dokumentin që vërteton objektin e veprimtarisë, numrin unik të identifikimit të subjektit, adresën e zyrës qendrore të regjistruar dhe, nëse është e ndryshme, edhe vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë, si dhe të gjitha ndryshimet e bëra në çastin e kryerjes së transaksionit;

ç) për personat juridikë privatë, që nuk zhvillojnë veprimtari fitimprurëse: emrin, numrin dhe datën e vendimit të gjykatës për regjistrimin si person juridik, statutin dhe aktin e themelimit, numrin unik të identifikimit të subjektit, selinë e përhershme dhe, nëse është e ndryshme, edhe vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë, natyrën e veprimtarisë, përfaqësuesit ligjorë, si dhe personat që mbajnë pozicion drejtues vendimmarrës;

d) për përfaqësuesit ligjorë ose me prokurë të klientit: emrin, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, shtetësinë, vendbanimin e përkohshëm (nëse ka) dhe të përhershëm, punësimin, llojin dhe numrin e dokumentit të identifikimit, numrin personal për shtetasit e Republikës së Shqipërisë, si dhe atë të barasvlershëm për shtetasit e huaj, autoritetin që e ka lëshuar dhe kopjen e aktit të përfaqësimit.

dh) për organizimet ligjore: identifikimin e themeluesit, të përfituesit, të kujdestarit ose të personit që ushtron kontroll faktik mbi to, sipas të dhënave të parashikuara në shkronjat e mësipërme, në varësi të faktit nëse është person fizik ose person juridik privat.

2. Subjektet pranojnë nga klienti për të marrë të dhëna për të, sipas përcaktimeve të këtij neni, vetëm dokumente origjinale ose fotokopje të noterizuara ose dokument elektronik që plotëson kushtet e vlefshmërisë, sipas legjislacionit në fuqi për dokumentin elektronik ose nënshkrimin elektronik. Për qëllime të këtij ligji, subjekti mban në dosjen e klientit kopje të vulosura me vulën e subjektit, të dokumenteve të paraqitura nga klienti në formën e mësipërme, brenda afatit të vlefshmërisë së tyre.

2/1. Për identifikimin elektronik të klientit, verifikimin e identitetit, mbajtjen e të dhënave dhe dokumentacionit, subjektet e këtij ligji mbështeten në shërbimet e besuara për skemat e identifikimit elektronik sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës në fuqi, parashikimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore përkatëse.

3. Subjektet, kur e gjykojnë të nevojshme, duhet të kërkojnë paraqitjen nga klienti të dokumenteve të tjera identifikuese për verifikimin e të dhënave të paraqitura prej këtij të fundit.

## Neni 6

### **Zhvillimet teknologjike**

*(ndryshuar me ligjin nr. 66/2012, datë 7.6.2012; ndryshuar titulli i nenit, zëvendësuar shprehje në pikën 1, paragrafi i dytë, shfuqizuar pika 3 me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019; ndryshuar fjalia hyrëse e pikës 1 me ligjin nr. 37/2026, datë 9.4.2026)*

1. Subjektet duhet të zbatojnë politika dhe të marrin masat e duhura, sipas rastit, për identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit apo financimit të armëve të dëmtimit në masë që lidhen me:

a) zhvillimet e produkteve të reja, praktikat e biznesit, mënyrat e ofrimit apo kanalet e shpërndarjes;

b) përdorimin e teknologjive të reja apo atyre që janë në zhvillim.

Këto masa duhet të zbatohen përpara futjes në përdorim të produkteve të reja dhe praktikave të biznesit apo teknologjive të reja, për produktet e reja dhe ekzistuese, në mënyrë që të administrohen dhe të ulen rreziqet e identifikuar.

2. Subjektet duhet të zbatojnë procedura specifike dhe të marrin masat e duhura e të efektshme për të parandaluar rrezikun që lidhet me transaksionet apo marrëdhëniet e biznesit, të kryera pa praninë fizike të klientit.

3. Shfuqizuar.

Neni 6/1

### **Mbështetja në palë të treta**

*(shtuar me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019; ndryshuar fjalë në shkronjën "c" të pikës 1, shtuar fjalë në fund të fjalisë së dytë të pikës 3 me ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021; ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 62/2023, datë 21.7.2023)*

1. Subjektet mund të mbështeten në palët e treta për të kryer masat e parashikuara në këtë ligj me kusht që të sigurohen për përmbushjen e kriterëve si më poshtë:

a) subjekti që mbështetet në një palë të tretë duhet të jetë në gjendje të marrë menjëherë informacionin e nevojshëm për secilën nga pikat e mësipërme;

b) subjekti duhet të marrë masat e duhura për t'u siguruar se kopjet e të dhënave identifikuese dhe dokumentacioni tjetër përkatës lidhur me detyrimet për vigjilencën e duhur të vihen në dispozicion menjëherë nga pala e tretë, sipas kërkesave të vetë subjektit apo autoriteteve përkatëse në zbatim të këtij ligji;

c) subjekti duhet të sigurohet se pala e tretë është e rregulluar me ligj, mbikëqyret apo monitorohet nga autoriteti përkatës për sistemin parandalues të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ka strukturë kontrolli të brendshëm të ngarkuar edhe me kontrollin e përputhshmërisë me këto detyrime, si dhe ka marrë masat e përshtatshme për përputhjen me kërkesat për masat e vigjilencës së duhur dhe ruajtjes së të dhënave, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. Në çdo rast, nëse detyrimet nuk përmbushen nga palët e treta, përgjegjësia ligjore mbetet e subjektit të këtij ligji që mbështetet te pala e tretë.

3. Gjatë vendosjes së marrëdhënies me palë të treta jashtë vendit duhet të merret në konsideratë edhe informacioni në dispozicion mbi nivelin e rrezikut të atij vendi. Ndalohet mbështetja në palë të treta të krijuara në vende me risk të lartë përveç nëse pala e tretë është një degë ose filial përfaqësimi me pronësi të shumicës së aksioneve të subjektit të detyruar, të krijuar në Shqipëri sipas politikave dhe procedurave të shoqërisë mëmë, të cilat janë në përputhje me këtë ligj.

4. Ndalohet mbështetja në palë të treta për rastet e parashikuara në këtë ligj, si dhe në rastet kur kjo vendoset nga autoriteti përgjegjës.

## **KREU III**

### **VIGJILENCA E ZGJERUAR NDAJ KLIENITIT**

Neni 7

#### **Vigjilenca e zgjeruar ndaj klientit**

*(ndryshuar pika 1 dhe shtuar pika 3 me ligjin nr. 66/2012, datë 7.6.2012; shtuar fjalë në pikën 1, riformuluar pika 2, zëvendësuar fjalë në pikën 3 me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019; ndryshuar fjalë e dytë e pikë 1 dhe shtuar një fjalë në fund të pikës 3 me ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021; ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 62/2023, datë 21.7.2023)*

1. Vigjilenca e zgjeruar duhet të përfshijë masa shtesë, përveç atyre të parashikuara për vigjilencën e duhur, për marrëdhëniet e biznesit, klientët apo transaksionet me rrezik të lartë. Për zvogëlimin e rrezikut të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, krahas

kategorive të përcaktuara në këtë ligj dhe faktorëve e situatave të përcaktuara në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij me vendim të Këshillit të Ministrave, subjektet përcaktojnë kategori të tjera marrëdhëniesh biznesi, klientësh, transaksionesh, produktesh, shërbimesh, kanalesh shpërndarjeje, vendesh ose rreziqesh gjeografike, të vlerësuara me rrezik të lartë dhe ndaj të cilave duhet të zbatohen masat e vigjilencës së zgjeruar.

2. Për zbatimin e vigjilencës së zgjeruar ndaj klientëve, subjektet mund të kërkojnë praninë fizike të klientëve dhe të përfaqësuesve të tyre para se të vendosin një marrëdhënie biznesi.

3. Kur subjektet janë të paafta që të plotësojnë detyrimet për vigjilencën e zgjeruar ndaj klientit, ato duhet të zbatojnë masat e parashikuara në pikën 2, të nenit 4/1, të këtij ligji.

#### Neni 8

### **Kategoritë e klientëve dhe transaksioneve, ndaj të cilëve zbatohet vigjilenca e zgjeruar**

*(ndryshuar pikat 1 dhe 2 me ligjin nr.10/391, datë 3.3.2011; ndryshuar pika 1 dhe shtuar pikat 4, 5 dhe 6 me ligjin nr. 66/2012, datë 7.6.2012; ndryshuar titulli, shtuar shkronja "d", ndryshuar pika 5 dhe 6, shtuar pikat 7, 8, 9, 10 e 11 me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019; shtuar pikat 2/1, 5/1 dhe ndryshuar pika 11 me ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021; ndryshuar fjalë në pikën 4 me ligjin nr. 62/2023, datë 21.7.2023; shtuar fjalë në pikën 3 me ligjin nr. 37/2026, datë 9.4.2026)*

1. Për personat e ekspozuar politikisht, subjektet duhet:

a) të hartojnë dhe të zbatojnë sisteme efektive të menaxhimit të riskut për të përcaktuar nëse një klient ekzistues apo potencial ose pronari përfitues është një person i ekspozuar politikisht;

b) të marrin miratimin e drejtuesve të lartë për vendosjen e marrëdhënies të biznesit me personat e ekspozuar politikisht;

c) të kërkojnë dhe të marrin miratimin e drejtuesve të lartë për vazhdimin e marrëdhënies së biznesit, në rastet kur marrëdhënia e biznesit me klientin është vendosur dhe subjekti konstaton që klienti apo pronari përfitues është bërë ose bëhet më pas person i ekspozuar politikisht;

ç) të marrin masa të arsyeshme për të kuptuar burimin e pasurisë dhe të fondeve të klientëve e të pronarëve përfitues, të identifikuar si persona të ekspozuar politikisht.

d) të marrin masat për të verifikuar nëse përfituesit apo pronarët përfitues në policat e sigurimit të jetës janë persona të ekspozuar politikisht, jo më vonë se në momentin e pagesës. Kur identifikohen rreziqe të larta, njoftohen drejtuesit e lartë përpara kryerjes së pagesës, kryhet verifikim i hollësishëm i marrëdhënies së biznesit me mbajtësin e policës, si dhe konsiderohet raportimi i aktivitetit të dyshimtë.

2. Në rastet kur subjektet kanë një marrëdhënie biznesi me personat e ekspozuar politikisht, ata duhet të mbikëqyrin me vigjilencë të zgjeruar këtë marrëdhënie.

2/1. Për anëtarët e familjes, personat e lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi të personave të ekspozuar politikisht zbatohen masat e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

3. Për klientët, të cilët janë organizata jofitimprurëse të konsideruara me rrezik të lartë, subjektet duhet:

a) të mbledhin informacione të mjaftueshme për to, për të kuptuar plotësisht burimet e financimit, natyrën e veprimtarisë dhe mënyrën e administrimit dhe drejtimit të tyre;

b) të përcaktojnë nëpërmjet informacionit publik ose me mjete të tjera reputacionin e tyre;

c) të marrin miratimin nga instancat më të larta të administrimit/drejtimit përpara vendosjes së një marrëdhënieje biznesi me ta;

ç) të ofrojnë monitorim të zgjeruar të marrëdhënies së biznesit.

4. Subjektet duhet t'u kushtojnë vigjilencë të zgjeruar marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve me klientët jorezidentë, të vlerësuara me risk të lartë.

5. Subjektet duhet të verifikojnë dhe t'u kushtojnë vigjilencë të zgjeruar marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve me të gjitha kategoritë e klientëve, të cilët banojnë ose e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vende për të cilat kërkohet marrja e masave të posaçme, sipas përcaktimeve apo kërkesave të autoritetit përgjegjës. Subjektet duhet të analizojnë arsyet dhe qëllimin e kryerjes së transaksioneve të tilla dhe të mbajnë të dhëna me shkrim për konkluzionet, të cilat duhet t'u vihen në dispozicion autoritetit përgjegjës mbikëqyrës dhe audituesve, nëse kërkohet. Autoriteti përgjegjës mund të kërkojë marrje masash shtesë dhe kufizime përtej vigjilencës së zgjeruar.

5/1. Në lidhje me marrëdhëniet e biznesit apo transaksionet që përfshijnë vendet me risk të lartë sipas shkronjës "F" të nenit 22 të këtij ligji, subjektet duhet të zbatojnë masat e mëposhtme të vigjilencës së zgjeruar ndaj klientit:

a) të marrin informacion shtesë për klientin dhe pronarin përfitues;

b) të marrin informacion shtesë për natyrën e marrëdhënies së biznesit;

c) të marrin informacion për burimin e fondeve dhe burimin e pasurisë së klientit dhe pronarit përfitues;

ç) të marrin informacion për arsyet e transaksioneve të synuara ose të kryera;

d) të marrin miratimin e drejtuesve të lartë për vendosjen ose vazhdimin e marrëdhënies të biznesit;

dh) të kryejnë monitorim të zgjeruar të marrëdhënies të biznesit duke rritur numrin, shpeshësinë apo periodicitetin e kontroleve të aplikuara dhe zgjedhjen e modeleve të transaksioneve që kanë nevojë për kontroll të mëtejshëm.

Krahas masave të mësipërme, subjektet zbatojnë një ose më shumë nga masat shtesë lidhur me klientët apo transaksionet që përfshijnë vende me risk të lartë:

i. zbatojnë elemente shtesë të vigjilencës së zgjeruar;

ii. përdorin mekanizma të përmirësuar për raportime apo raportim sistematik të transaksioneve financiare të personi/strukturat përgjegjëse brenda subjektit;

iii. kufizojnë marrëdhëniet e biznesit ose transaksionet me individët apo persona juridikë nga vendet me risk të lartë.

6. Subjektet duhet t'u kushtojnë vigjilencë të zgjeruar marrëdhënies të biznesit dhe transaksioneve me klientë organizimet ligjore apo shoqëritë që kanë aksione të mbajtësit, transaksioneve të kryera në emër apo për llogari të tyre, si dhe kur organizimet ligjore apo shoqëritë që kanë aksione të mbajtësit janë pjesë e strukturës së pronësisë, kontrollit apo vendimmarrjes së klientëve të tyre.

7. Subjektet duhet t'u kushtojnë vigjilencë të zgjeruar të gjitha transaksioneve komplekse, me vlera të larta dhe të pazakonta, të cilat nuk kanë qëllim të dukshëm ekonomik ose ligjor. Subjektet duhet të analizojnë arsyet dhe qëllimin e kryerjes së transaksioneve të tilla dhe të mbajnë të dhëna me shkrim për konkluzionet, të cilat duhet t'u vihen në dispozicion autoritetit përgjegjës, autoriteteve mbikëqyrëse dhe audituesve, nëse kërkohet.

8. Subjektet duhet t'u kushtojnë vigjilencë të zgjeruar marrëdhënies të biznesit dhe transaksioneve me klientë, të cilët vetë subjekti i ka kategorizuar me rrezik të lartë apo nëse gjatë një transaksioni apo marrëdhënieje biznesi identifikohen rreziqe të larta që nuk janë evidentuar më parë, parashikuar shprehimisht në ligj, ose në aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj.

9. Subjektet duhet t'u kushtojnë vigjilencë të zgjeruar marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve me klientë për të cilët autoriteti përgjegjës kërkon që ky proces të kryhet.

10. Përfituesi i policave të sigurimit të jetës duhet të konsiderohet si një faktor risku për të përcaktuar zbatimin ose jo të masave të vigjilencës së zgjeruar. Nëse përcaktohet që përfituesi, person fizik, juridik apo organizim ligjor paraqet rrezik të lartë, duhet të zbatohen masat e vigjilencës së zgjeruar që përfshijnë marrjen e masave për identifikimin dhe verifikimin e identitetit të pronarit përfitues, në momentin e pagesës.

11. Të dhënat, analizat, informacioni dhe dokumentacioni i mbledhur në zbatim të këtij neni ruhet për një periudhë 5-vjeçare nga data e përfundimit të marrëdhënies së biznesit ndërmjet klientit dhe subjektit ose nga data e transaksionit rastësor, por jo më shumë se 40 (dyzet) vjet nga data e secilit transaksion apo data e mbledhjes së dokumentacionit apo kryerjes së analizës.

#### Neni 9

### **Shërbimet bankare ose financiare korrespondente**

*(ndryshuar me ligjin nr.10 391, datë 3.3.2011 dhe nr. 66/2012, datë 7.6.2012; ndryshuar titulli, shfuqizuar pika 1, zëvendësuar dhe shtuar fjalë në pikën 2, shtuar fjalë në pikën 3, zëvendësuar fjalë në pikën 4, ndryshuar pika 5 me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019)*

1. Shfuqizuar.

2. Për shërbimet bankare ose financiare korrespondente ndërkufitare, të ofruara nga bankat subjekte të këtij ligji, përpara se të vendosin një marrëdhënie biznesi, ato duhet:

a) të grumbullojnë informacion të mjaftueshëm rreth institucionit pritës dhe ndërmjetësues, për të kuptuar plotësisht natyrën e biznesit;

b) të përcaktojnë, nëpërmjet informacionit publik, reputacionin e institucionit pritës dhe ndërmjetësues, cilësinë e mbikëqyrjes së tij, përfshirë faktin nëse ka qenë subjekt hetimi apo masash administrative që lidhen me pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit;

c) të vlerësojnë se procedurat e kontrollit të brendshëm të institucionit pritës dhe ndërmjetësues kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit janë të mjaftueshme dhe efektive;

ç) të marrin miratimin e instancave më të larta të administrimit/drejtimin dhe të dokumentojnë respektivisht për çdo institucion përgjegjës të përparandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit;

d) të hartojnë procedura të veçanta për monitorimin e vazhdueshëm të transaksioneve të drejtpërdrejta elektronike.

3. Subjekteve u ndalohet që të vendosin apo të vazhdojnë marrëdhënie bankare ose financiare korrespondente me banka guaskë.

4. Subjektet duhet të marrin masat e duhura, në mënyrë që të krijojnë bindjen se bankat ose institucionet financiare të huaja korrespondente nuk lejojnë që llogaritë e tyre të përdoren nga bankat guaskë. Subjektet duhet të ndërpresin marrëdhëniet e biznesit dhe t'i raportojnë autoritetit përgjegjës, kur vlerësojnë se llogaritë e bankës korrespondente përdoren nga bankat guaskë.

5. Për rastet kur marrëdhënia korrespondente përfshin mbajtjen e llogarive transitore, subjektet duhet të sigurohen që institucioni financiar korrespondent:

a) ka ndërmarrë masat e vigjilencës së duhur për klientët që kanë akses të drejtpërdrejtë në këto llogari;

b) është në gjendje, nëse i kërkohet, të paraqesë informacionin përkatës që rrjedh nga masat e vigjilencës së duhur, nëse kërkohet nga institucioni financiar korrespondent.

## Neni 10

### **Detyrime për shërbimin e transferimit të parave ose të vlerave**

*(ndryshuar pika 1, 3 dhe shtuar pika 4 me ligjin nr. 66/2012, datë 7.6.2012; shtuar pikat 3/1, 3/2 e 3/3, shtuar pika 5 me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019; ndryshuar fjalia e parë e pikës 1, hequr fjalië në pikën 4, ndryshuar pika 5 dhe shtuar pika 6 me ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021)*

1. Subjektet, veprimtaritë e të cilave përfshijnë transferta parash ose vlerash, në rastin e transfertave në nisje dhe në mbërritje, duhet të marrin dhe të identifikojnë emrin, mbiemrin, adresën, numrin e dokumentit të identifikimit ose numrin e llogarisë së dërguesit dhe përfituesit, si dhe emrin e institucionit financiar të përfshirë në transfertë. Informacioni duhet të përfshihet në formularin e mesazhit ose të pagesës që shoqëron transfertën. Në rast se nuk ka një numër llogarie, transferta shoqërohet nga një numër unik reference.

2. Subjektet e transmetojnë informacionin së bashku me pagesën, përfshirë edhe rastin kur ata veprojnë si ndërmjetës në një zinxhir pagesash.

3. Nëse subjekti i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni merr transferta parash ose vlerash, përfshirë dhe ato të drejtpërdrejta elektronike, që nuk përmbajnë informacionin e plotë për urdhëruesin, ai duhet ta kërkojë informacionin që mungon nga institucioni dërgues. Nëse nuk arrin ta regjistrojë informacionin që mungon, ai duhet të refuzojë pranimin e transfertës dhe t'ia raportojë atë autoritetit përgjegjës.

3/1. Në rastin kur subjektet e përcaktuara në shkronjën “a”, të nenit 3, të këtij ligji, veprojnë si institucione financiare korrespondente dhe/ose ndërmjetëse, marrin masa të arsyeshme për identifikimin e transfertave ndërkufitare, që kanë mangësi në informacionin rreth urdhëruesit apo përfituesit, si dhe zbatojnë politika dhe procedura të bazuara mbi rrezikun, për të përcaktuar:

- a) kur të kryhet, refuzohet apo pezullohet një transfertë me mangësitë e mësipërme;
- b) veprimet e duhura vijuese.

Në rastin kur subjektet e përcaktuara në shkronjën “a”, të nenit 3, të këtij ligji, veprojnë si institucione financiare korrespondente dhe/ose ndërmjetëse, marrin masa të arsyeshme.

3/2. Për transfertat ndërkufitare mbi pragun e përcaktuar në nenin 4, të këtij ligji, subjektet financiare përfituese duhet të verifikojnë identitetin e përfituesit, nëse ky proces nuk është kryer më parë.

3/3. Subjektet ndalohet të kryejnë transferta parash ose vlerash për persona të shpallur nga vendime të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, sipas akteve përkatëse të organizatave ndërkombëtare ose të marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë, edhe përpara miratimit të tyre nga proceduara ligjore apo nënligjore brenda vendit, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për masat kundër financimit të terrorizimit.

4. Subjektet, veprimtaritë e të cilave përfshijnë transferta parash ose vlerash, duhet të mbajnë një listë të agjentëve që operojnë për llogari të tyre dhe ta vënë në dispozicion të autoritetit përgjegjës, autoriteteve mbikëqyrëse dhe audituesve, nëse kërkohet. Për qëllim të këtij ligji, këta agjentë do të konsiderohen si pjesë e subjektit.

5. Të dhënat, informacioni dhe dokumentacioni i mbledhur në zbatim të këtij neni ruhen për një periudhë 5-vjeçare nga data e përfundimit të marrëdhënies së biznesit ndërmjet klientit dhe subjektit ose nga data e transaksionit rastësor, por jo më shumë se 40 (dyzet) vjet nga data e secilit transaksion apo data e mbledhjes së dokumentacionit apo kryerjes së analizës.

6. Detyrimet e këtij neni zbatohen edhe nga ofruesit e shërbimeve të mjeteve virtuale.

**Masat parandaluese të ndërmarra nga subjektet**

*(shtuar një fjali në fund të shkronjës “b” të pikës 1 me ligjin nr.10 391, datë 3.3.2011; ndryshuar shkronja “b”, “e” të pikës 1 dhe shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 66/2012, datë 7.6.2012; ndryshuar shkronja “a” dhe shtuar shkronjat “a/1” dhe “a/2”, ndryshuar shkronja “ç” dhe shtuar shkronja “db/1” e pikës 1, shtuar pikat 1/1 e 1/2, shtuar pika 4 me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019; shtuar një fjali në fund të nënndarjes “ii”, ndryshuar nënndarja “iii” të shkronjës “a/1” të pikës 1, shtuar shkronjat “b/1” dhe “b/2” të pikës 1, shtuar fjali në shkronjën “d” dhe shtuar pika 5 me ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021; ndryshuar fjalia hyrëse e shkronjës “a”, “a/1”, shtuar nënndarja “vi”, ndryshuar shkronja “c” me ligjin nr. 37/2026, datë 9.4.2026)*

1. Në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, subjektet kanë detyrimet e mëposhtme:

a) Të hartojnë, të përditësojnë dhe të zbatojnë në mënyrë efektive rregulloret dhe/ose udhëzimet e brendshme, të cilat, në përputhje me natyrën dhe përmasat e subjektit, parashikojnë marrjen e masave të përshtatshme për të kuptuar rrezikun e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit apo financimit të armëve të dëmtimit në masë, që mund të lindë nga klientë ose transaksione, duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në:

i) një politikë për pranimin e klientit;

ii) një politikë për zbatimin marrëdhënies së biznesit, të procedurave për vigjilencën e zgjeruar në rastin e klientëve dhe transaksioneve që paraqesin rrezik të lartë. Faktorët minimalë që duhet të vlerësohen janë qëllimi i hapjes së llogarisë apo vendosjes së marrëdhënies, niveli i aseteve që do të depozitohen nga klienti apo madhësia e transaksioneve, rregullshmëria ose kohëzgjatja e marrëdhënies së biznesit;

iii. të marrin në konsideratë vlerësimet kombëtare të riskut, vlerësimet sektoriale, të dhëna të tjera të ngjashme, rekomandimet e autoritetit përgjegjës dhe/ose autoriteteve mbikëqyrëse, si dhe vlerësime ose raporte të hartuara nga organizata ndërkombëtare dhe autoritete me kompetencë në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për sa i përket riskut që përbëjnë vende të veçanta;

a/1 Të identifikojnë, të vlerësojnë dhe të kuptojnë rreziqet e tyre të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit apo financimit të armëve të dëmtimit në masë, për klientët, vendet apo zonat gjeografike, produktet, shërbimet, transaksionet apo kanalet e shpërndarjes. Për realizimin e këtij parashikimi kërkohet që subjektet:

i) të dokumentojnë vlerësimet e tyre të riskut;

ii) të marrin në konsideratë të gjithë faktorët e riskut, përpara se të përcaktojnë nivelin e përgjithshëm të rrezikut, nivelin dhe llojin e masave zbutëse që duhet të zbatohen;

iii) të marrin në konsideratë vlerësimet kombëtare të riskut, vlerësimet sektoriale, të dhëna të tjera të ngjashme, si dhe rekomandimet e autoritetit përgjegjës dhe/ose autoriteteve mbikëqyrëse;

iv) të mbajnë të përditësuara vlerësimet e kryera;

v) të ngrenë mekanizma të përshtatshëm për të ofruar vlerësimet e riskut të kryera për autoritetet përgjegjëse, autoritetet mbikëqyrëse, si dhe organe të tjera të përcaktuara me ligj;

vi) të monitorojnë zbatimin e masave dhe kontrolleve të mësipërme, si dhe të zbatojnë masa shtesë, nëse është e nevojshme;

a/2) të marrin masa shtesë për të menaxhuar dhe zbutur rreziqet e larta kur identifikohen;

b) të emërojnë një person përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, në nivele administrimi/drejtimi në zyrën qendrore dhe në çdo zyrë

përfaqësimi, filial, degë ose agjenci, te të cilat të gjithë punonjësit raportojnë çdo fakt që mund të përbëjë dyshim për pastrim parash ose financim terrorizmi dhe të përcaktojnë procedura të përshtatshme menaxhimi e përputhshmërie, brenda subjektit dhe degëve. Personat përgjegjës kanë akses të vazhdueshëm ndaj të gjitha të dhënave, të parashikuara në nenin 16 të këtij ligji, dhe në çdo lloj informacioni që disponohet nga subjekti, i cili është i nevojshëm për përmbushjen e detyrave.

b/1) personi përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit duhet të jetë drejtues ose punonjës me njohuri të mjaftueshme për rrezikun e ekspozimit ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të subjektit dhe të ketë kompetencë për të marrë vendime që ndikojnë në ekspozimin ndaj riskut dhe që nuk nevojitet në të gjitha rastet të jetë anëtar i bordit të drejtorëve;

b/2) personi përgjegjës i emëruar sipas parashikimeve të pikës 1, shkronja “b”, të këtij neni, është personi që dërgon raportet sipas nenit 12, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji, si dhe u kthen përgjigje kërkesave të autoritetit përgjegjës;

c) të krijojnë një sistem të centralizuar përgjegjës për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave, duke u siguruar për përditësimin e tij të vazhdueshëm, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe akteve nënligjore përkatëse;

ç) të zbatojnë procedura përzgjedhëse për rekrutimin e punonjësve të rinj, si dhe procedura për verifikimin e punonjësve ekzistues, të cilat parashikojnë standarde për garantimin e integritetit etik dhe moral dhe aftësive të tyre profesionale;

d) të trajnojnë punonjësit për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit përfshirë detyrimin për mosdeklarim sipas nenit 15 të këtij ligji, si dhe mbrojtjen e të dhënave personale përmes organizimit periodik të programeve të kualifikimit;

dh) të ngarkojnë kontrollin e brendshëm për të kontrolluar përputhshmërinë me detyrimet e këtij ligji dhe të akteve përkatëse nënligjore;

dh/1) në përpjesëtim me natyrën e biznesit dhe madhësinë vetë e subjektit, të zbatojnë, për punonjësit e tyre të të gjitha niveleve procedura të përshtatshme për raportimin e shkeljeve brenda subjektit, nëpërmjet një sistemi specifik, të pavarur dhe anonim, për sa ka lidhje me detyrimet e parashikuara në këtë ligj;

e) të sigurohen se filialet, degët dhe nëndegët, si dhe agjencitë e tyre, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe, në veçanti, në vende dhe territore, të cilat nuk zbatojnë apo zbatojnë pjesërisht standardet ndërkombëtare, veprojnë në përputhje me masat parandaluese të parashikuara në këtë ligj. Në qoftë se masat parandaluese në dy vendet ndryshojnë, atëherë subjektet duhet të sigurohen që kanë përparësi detyrimet më të larta. Nëse ligjet e vendit, ku janë vendosur filialet, degët, nëndegët ose agjencitë, parashikojnë pengesa për zbatimin e detyrimeve, subjekti duhet t'i raportojë për këto pengesa autoritetit përgjegjës dhe, sipas rastit, autoritetit mbikëqyrës.

ë) të paraqesin informacion, të dhëna dhe dokumente shtesë, autoritetit përgjegjës, në përputhje me kërkesat dhe afatet kohore për rastet e parashikuara në këtë ligj. Autoriteti përgjegjës mund ta zgjasë këtë afat, me kërkesë të subjektit, për një periudhë jo më shumë se 15 ditë.

1/1. Rregulloret, procedurat dhe udhëzimet e brendshme të miratuara nga subjektet, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj, miratohen nga drejtues të nivelit të lartë të subjektit që janë përfaqësues ligjorë të tij apo nga bordi drejtues.

1/2. Subjektet, që janë pjesë e grupeve bankare dhe/ose financiare, duhet të zbatojnë programet e grupit kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, për sa janë në përputhje me detyrimet e parashikuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Këto programe dhe masa, përveç atyre të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, duhet të përfshijnë:

a) politika dhe procedura për ndarjen e informacionit të kërkuar për qëllimet e vigjilencës së duhur dhe menaxhimit të rrezikut të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit;

b) parashikimin, në nivel grupi, të strukturave të auditit dhe/ose funksioneve të përputhshmërisë për klientët, llogaritë dhe informacionin mbi transaksionet nga çdo strukturë brenda subjektit, kur është e nevojshme, për qëllimin e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke përfshirë informacion dhe analizë transaksionesh apo aktivitete, që duken të pazakonta, nëse një analizë e tillë është kryer; si dhe

c) masa të përshtatshme për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit të shkëmbyer, për të parandaluar nxjerrjen e paautorizuar të tij.

2. Shfuqizuar.

3. Në rast se numri i punonjësve të subjekteve të përcaktuara në këtë ligj është më pak se 3 persona, detyrimet e këtij neni përmbushen nga administratori ose nga një punonjës i autorizuar i subjektit.

4. Subjektet duhet të zbatojnë detyrimet e parashikuara në këtë nen, në përputhje me rreziqet për pastrim parash dhe financim terrorizmi, bazuar në madhësinë dhe natyrën e biznesit të subjektit.

5. Kur një individ, që bën pjesë në kategoritë e parashikuara në nenin 3 të këtij ligji, ushtron veprimtarinë profesionale si i punësuar i një personi juridik apo personi fizik tregtar, detyrimet e këtij neni zbatohen vetëm nga punëdhënësi.

## KREU IV DETYRIMI PËR RAPORTIM

### Neni 12

#### **Raportimi tek autoriteti përgjegjës**

*(ndryshuar me ligjin nr.10 391, datë 3.3.2011 dhe nr. 66/2012, datë 7.6.2012; hequr fjalë në pikën 2, shtuar fjali në fund të pikës 3 me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019; ndryshuar fjalia e fundit e pikës 3 me ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021)*

1. Subjektet i paraqesin një raport autoritetit përgjegjës, ku parashirojnë dyshimet që kanë për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale, financimi i terrorizmit apo fondet e përfshira rrjedhin nga veprimtari kriminale. Raportimi bëhet menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë.

2. Kur subjekti, ka dyshime se transaksioni mund të përfshijë pastrim të produkteve të veprës penale, financim terrorizmi apo fonde që rrjedhin nga veprimtari kriminale, ai duhet të mos e kryejë transaksionin, t'ia raportojë menjëherë rastin autoritetit përgjegjës dhe të kërkojë udhëzime nëse duhet ta kryejë apo jo transaksionin. Brenda 48 orëve nga marrja dijani, autoriteti përgjegjës kthen përgjigje, duke parashtruar qëndrimin për lejimin e transaksionit ose nxjerrjen e urdhrat të bllokimit. Kur autoriteti përgjegjës nuk përgjigjet brenda afatit të parashikuar, subjekti mund të vazhdojë me kryerjen e transaksionit.

3. Subjekteve u kërkohet t'i raportojnë autoritetit përgjegjës, sipas afateve të përcaktuara në aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji, për të gjitha transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 000 000 (një milion) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën brenda 24 orëve. Nga ky detyrim përjashtohen transaksionet që kryhen nga organet apo

ndërmarrjet publike.

Neni 13

**Mbrojtja e identitetit të subjektit raportues**

*(ndryshuar fjalia e parë me ligjin nr.10 391, datë 3.3.2011 dhe nr. 66/2012, datë 7.6.2012)*

Për raportimet e aktivitetit të dyshimtë, të cilat autoriteti përgjegjës i merr në zbatim të këtij ligji, është i detyruar të ruajë identitetin e subjekteve raportuese dhe të punonjësve të tyre që kanë raportuar.

Neni 14

**Përgjashtimi nga përgjegjësia ligjore për raportim  
pranë autoritetit përgjegjës**

*(shtuar shprehje në fund të nenit me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019; numërtuar paragrafët dhe shtuar pika 2 me ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021)*

1. Subjektet ose autoritetet mbikëqyrëse, drejtuesit, zyrtarët ose punonjësit e tyre, të cilët në mirëbesim raportojnë ose japin informacion, në përputhje me dispozitat e këtij ligji pranë autoritetit përgjegjës, janë të përjashtuar nga përgjegjësia penale, civile ose administrative për nxjerrjen e sekretit profesional ose bankar të përcaktuar nga legjislacioni i posaçëm në fuqi.

2. Zgjidhja e kontratës së punës, masat disiplinore apo diskriminuese për punonjës të punës që përmbush detyrimin për raportim brenda subjektit ose tek autoriteti përgjegjës konsiderohen masa pa shkaqe të arsyeshme.

Neni 15

**Kërkesat për mosdeklarim**

*(ndryshuar me ligjin nr. 66/2012, datë 7.6.2012)*

Drejtuesve, zyrtarëve dhe punonjësve, të përkohshëm apo të përhershëm, të subjekteve, autoriteteve mbikëqyrëse apo institucioneve që u kërkohet të raportojnë pranë autoritetit përgjegjës, sipas këtij ligji, u ndalohej të informojnë klientin ose çdo person tjetër, për dërgimin apo përgatitjen për dërgim të informacionit për autoritetin përgjegjës, për raportimin e aktivitetit të dyshimtë, si dhe për çdo informacion që kërkohet nga ky i fundit apo për hetimet që janë duke u kryer.

Neni 15/1

**Mbrojtja e identitetit të subjektit raportues**

*(shtuar me ligjin nr.10 391, datë 3.3.2011 dhe shtuar me ligjin nr. 66/2012, datë 7.6.2012)*

Neni 16

*(ndryshuar pika 1 me ligjin nr.10 391, datë 3.3.2011; ndryshuar fjalia e parë e pikës 1 dhe 2 me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019; ndryshuar me ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021)*

1. Subjektet duhet të ruajnë dokumentet që rrjedhin nga procesi i vigjilencës së duhur dhe asaj të zgjeruar, të dhënat e llogarive, transaksioneve, korrespondencën me klientin, si dhe rezultatet e analizave të kryera për 5 vjet nga data e përfundimit të marrëdhënies së biznesit ndërmjet klientit dhe subjektit apo nga data e transaksionit rastësor, por jo më shumë se 40

(dyzet) vjet nga data e secilit transaksion apo data e mbledhjes së dokumentacionit apo kryerjes së analizës.

2. Subjektet duhet të mbajnë regjistra për të dhënat, raportimet dhe dokumentacionin për transaksionet kombëtare dhe ndërkombëtare, pavarësisht nëse transaksioni është kryer në emër të klientit ose në emër të palëve të treta, së bashku me të gjithë dokumentacionin mbështetës, përfshirë dosjet e llogarive dhe korrespondencën e biznesit, për 5 (pesë) vjet nga data e përfundimit të marrëdhënies së biznesit ndërmjet klientit dhe subjektit apo nga data e transaksionit rastësor, por jo më shumë se 40 (dyzet) vjet nga data e secilit transaksion në veçanti apo data e mbledhjes së dokumentacionit apo e kryerjes së analizës.

3. Subjektet duhet të ruajnë të dhëna për transaksionet, përfshirë edhe ato të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, me të gjitha hollësitë e duhura për të lejuar rindërtimin e ciklit të plotë të transaksioneve, me qëllim sigurimin e informacionit për autoritetin përgjegjës dhe për autoritetet e tjera kompetente, në bazë të këtij ligji e të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Ky informacion ruhet për 5 (pesë) vjet nga data e përfundimit të marrëdhënies së biznesit ndërmjet klientit dhe subjektit apo nga data e transaksionit rastësor, por jo më shumë se 40 (dyzet) vjet nga data e secilit transaksion në veçanti apo data e mbledhjes së dokumentacionit apo e kryerjes së analizës.

4. Me kërkesë të autoritetit përgjegjës dhe të autoriteteve të tjera kompetente, dokumentacioni ruhet edhe për 5 (pesë) vjet të tjera nga data e përfundimit të marrëdhënies së biznesit ndërmjet klientit dhe subjektit apo nga data e transaksionit rastësor, por jo më shumë se 40 (dyzet) vjet nga data e secilit transaksion në veçanti apo data e mbledhjes së dokumentacionit apo e kryerjes së analizës.

5. Dokumentacioni i parashikuar në këtë nen ruhet në formë shkresore ose elektronike, në varësi të mënyrës së krijimit.

6. Subjektet duhet të sigurohen që të gjitha të dhënat për klientin dhe transaksionin dhe informacioni i kërkuar për t'u mbajtur, sipas kësaj dispozite, të vihen menjëherë në dispozicion me kërkesën e autoritetit përgjegjës dhe të autoriteteve të tjera kompetente.

Neni 16/1

### **Mbrojtja e të dhënave personale**

*(shtuar me ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021)*

Përpunimi i të dhënave personale në zbatim të këtij ligji bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 17

### **Raportimi i organeve doganore**

*(ndryshuar me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019; ndryshuar referenca ligjore në pikën 2 me ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021)*

1. Autoritetet doganore duhet t'i raportojnë menjëherë, dhe jo më vonë se 72 orë, autoritetit përgjegjës çdo dyshim, informacion ose të dhënë, që kanë lidhje me pastrim parash ose financim terrorizmi, për veprimtaritë nën juridiksionin e tyre.

2. Organet doganore zbatojnë kërkesat e nenit 28, pika 3, shkronja "b", të këtij ligji.

Neni 17/1

### **Deklarimet në kufi**

*(shtuar me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019)*

1. Çdo person, i cili hyn në/ose largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë, është i detyruar të deklarojë shumat në të holla, çdo lloj instrumenti të negociueshëm të mbajtësit, metalet ose gurët e çmuar, sendet me vlerë dhe objektet antike, duke filluar nga shuma 10 000 euro ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera, qëllimin e mbajtjes së tyre, si dhe të paraqesë dokumente justifikuese përkatëse.

2. Detyrimin për deklarim, sipas pikës 1, të këtij neni e kanë edhe përfaqësuesit e personave që hyjnë në/ose largohen nga territori i Republikës së Shqipërisë me çfarëdolloj mjete transporti në rrugë tokësore, ajrore ose detare apo dhe nëpërmjet shërbimit postar.

3. Autoritetet doganore depozitojnë/raportojnë tek autoriteti përgjegjës kopje të formularëve të deklarimeve, dokumentet justifikuese të paraqitura dhe të dhëna të tjera, sipas rastit, si dhe të dhënat e plota për rastet e mosdeklarimeve.

4. Në rast kur autoritetet doganore kryesisht ose në bashkëpunim me strukturat kompetente të Policisë së Shtetit konstatojnë mosdeklarimin, sipas pikës 1, të këtij neni, paralelisht me trajtimin e rastit, sipas dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, vendosin gjobë, e cila për herën e parë në varësi të shumës së padeklaruar është në shumë fikse, dhe për raste të përsëritura do të përlogaritet si përqindje ndaj vlerës së padeklaruar si më poshtë:

a) për shumat nga 10 000 - 19 999 euro ose kundërvlerën e tyre në monedha të tjera të huaja, gjoba është në shumën 20 000 (njëzet mijë) lekë për herën e parë, 10 % të vlerës së padeklaruar për herën e dytë, si dhe 30 % të vlerës së padeklaruar për rastet e tjera;

b) për shumat nga 20 000 – 49 999 euro ose kundërvlerën e tyre në monedha të tjera të huaja, gjoba është në shumën 40 000 (dyzet mijë) lekë për herën e parë, 20 % të vlerës së padeklaruar për herën e dytë, si dhe 40 % të vlerës së padeklaruar për rastet e tjera;

c) për shumat mbi 50 000 euro ose kundërvlerën e tyre në monedha të tjera të huaja, gjoba është në shumën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë për herën e parë, 30 % të vlerës së padeklaruar për herën e dytë, si dhe 50 % të vlerës së padeklaruar për rastet e tjera.

5. Këshilli i Ministrave nxjerr rregulla të hollësishme për mënyrën e zbatimit të këtij neni.

Neni 18

#### **Raportimi i organeve tatimore**

*(shtuar dhe ndryshuar referenca ligjore në pikën 1 dhe 2 me ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021)*

1. Organet tatimore identifikojnë subjektet e tyre, sipas procedurave të parashikuara në nenin 4, shkronjat “c” dhe “ç”, të këtij ligji dhe i raportojnë autoritetit përgjegjës menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 72 orë pas regjistrimit të veprimit, për çdo dyshim, sinjalizim, njoftim ose të dhënë, që ka të bëjë me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

2. Organet tatimore zbatojnë kërkesat e nenit 28, pika 3, shkronja “c”, të këtij ligji.

Neni 19

#### **Raportimi i Agjencisë Shtetërore e Kadastrës**

1. Agjencia Shtetërore e Kadastrës raporton brenda 72 orëve regjistrimin e kontratës së tjetërsimit të pronës me një vlerë të barabartë ose më të madhe se 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja.

2. Agjencia Shtetërore e Kadastrës raporton menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë pranë autoritetit përgjegjës çdo dyshim, informacion ose të dhëna për pastrim parash apo financim terrorizmi për veprimtaritë nën juridiksionin e vet.

3. Agjencia Shtetërore e Kadastrës zbaton kërkesat e neneve 5 dhe 11 të këtij ligji.

Neni 20

### **Organizatave jofitimprurëse**

Çdo autoritet që regjistron, licencën dhe mbikëqyr veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse duhet të raportojë menjëherë tek autoriteti përgjegjës çdo dyshim, informacion ose të dhëna, lidhur me pastrim parash ose financim terrorizmi.

KREU V

## **STRUKTURAT PËRGJEGJËSE DHE MBIKËQYRËSE PËR ZBATIMIN E LIGJIT**

Neni 21

### **Organizimi i autoritetit përgjegjës**

*(shtuar pika 5 dhe 6 me ligjin nr.10 391, datë 3.3.2011; shtuar pika 1/1, ndryshuar pika 3 dhe 5, shfuqizuar pika 6 me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019; ndryshuar pika 1 dhe 3, ndryshuar emërtim në pikën 1/1, 2 dhe 5, shtuar pika 3/1 me ligjin nr. 62/2023, datë 21.7.2023)*

1. Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) organizohet si drejtori e përgjithshme në varësi të ministrit përgjegjës për financat dhe ushtron funksionet e autoritetit përgjegjës sipas këtij ligji. Kjo Agjenci brenda fushës së veprimtarisë së vet ka të drejtë të vendosë për mënyrën e ndjekjes dhe të zgjidhjes së çështjeve të trajtuara për pastrimin e mundshëm të parave dhe financimin e veprimtarive të mundshme terroriste.

1/1. Në funksion të ruajtjes së konfidencialitetit për fushën e veprimtarisë së vet, sigurisë së personelit apo sistemeve në përdorim, Agjencia e Inteligjencës Financiare mund të vendosë kufizime për të dhënat e kërkuara në funksion të së drejtës për informim, nëse kufizimi është i domosdoshëm dhe proporcional. Agjencia e Inteligjencës Financiare duhet të arsyetojë kufizimin rast pas rasti.

2. Në zbatim të këtij ligji, Agjencia e Inteligjencës Financiare shërben si njësi e specializuar financiare për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Gjithashtu, kjo drejtori funksionon si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit të të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

3. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të përgjithshëm, nëpunësve dhe punonjësve administrativë rregullohen në bazë të Kodit të Punës.

3/1. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës Financiare emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat.

4. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Agjencia e Inteligjencës Financiare, për sa i përket strukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) që ka në përdorim, ka kompetencat e mëposhtme:

a) ngre, mirëmban dhe administron sistemet, aplikacionet dhe infrastrukturën TIK, përfshirë edhe ato të klasifikuara si “sekret shtetëror”;

b) administron strukturën përkatëse të punonjësve të teknologjisë së informacionit në institucion;

c) organizon, kryen prokurimet dhe lidh kontratat për sistemet kompjuterike, mirëmbajtjen e tyre, për të gjitha kontratat e klasifikuara, sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”;

ç) administron kodin përkatës të çdo sistemi që përdoret për qëllime të funksionimit të institucionit;

d) përdor, aq sa është e mundur, shkëmbimin e të dhënave në mënyrë elektronike me bazat e të dhënave të ndërlidhura në platformën qeveritare të ndërveprimit;

dh) bashkëpunon me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI):

i) duke bashkërenduar projektet në fushën shoqërisë së informacionit;

ii) duke përdorur, aq sa është e mundur, standardet shqiptare në fushën TIK, të miratuara nga AKSHI, në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe shërbimet e përqendruara të TIK-ut, për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave;

iii) për të garantuar një nivel të lartë të sigurisë kibernetike dhe zgjidhjet ndaj incidenteve të sigurisë kompjuterike.

6. Shfuqizuar.

Neni 21/1

### **Detyrimi i subjekteve të ligjit dhe organeve publike për përgjigje ndaj kërkesave për informacion të autoritetit përgjegjës**

*(Shtuar me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019)*

1. Subjektet e këtij ligji, organet shtetërore apo entet publike janë të detyruara t'u përgjigjen kërkesave për informacion, të dhëna dhe dokumente, të dërguara nga autoriteti përgjegjës, pa zvarritje, brenda 10 ditëve kalendarike.

2. Në raste urgjente, autoriteti përgjegjës mund të kërkojë informacion edhe brenda një afati më të shkurtër sesa ai i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, dhe subjektet e këtij ligji, organet shtetërore apo entet publike janë të detyruara për dhënien e këtij informacioni.

Neni 22

### **Detyrat dhe funksionet e autoritetit përgjegjës**

*(ndryshuar shkronjat “a”, “c” dhe “e” me ligjin nr.10 391, datë 3.3.2011, ndryshuar shkronjat “ç”, “ë” e shtuar shkronjat “v”, “ll” me ligjin nr. 66/2012, datë 7.6.2012, ndryshuar pika “e”, shtuar shkronja “m” me ligjin nr. 44/2017, datë 6.4.2017; ndryshuar shkronja “b”, “e” dhe “j”, zëvendësuar fjalë në shkronjën “g”, hequr fjalë në shkronjën “gj” me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019; shtuar fjalë në shkronjën “ç”, shtuar shkronjat “d/1” dhe “e/1”, me ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021; ndryshuar emërtim në fjalinë e parë, ndryshuar togfjalësh në shkronjat “b” dhe “dh” me ligjin nr. 62/2023, datë 21.7.2023; ndryshuar fjalia e parë e shkronjës “g”, shtohet fjali, shtuar shkronja “g/1”, shfuqizaur shkronja “ll”, shtuar shkronja “ll/1” me ligjin nr. 37/2026, datë 9.4.2026)*

Agjencia e Inteligjencës Financiare, si njësi e inteligjencës financiare në zbatim të këtij ligji ka këto detyra dhe funksione:

a) mbledh, administron, përpunon, analizon dhe shpërndan tek autoritetet kompetente të dhëna, raporte dhe informacione për çështjet e pastrimit të parave dhe

financimit të terrorizmit;

b) ka akses të drejtpërdrejtë pa pagesë në sistemet e teknologjisë së informacionit apo bazat e të dhënave dhe në çdo informacion të administruar nga institucionet publike, pranë subjekteve private me pronar shtetëtar apo të dhëna nga shteti në favor të subjekteve private në bazë të një kontrate, si dhe në çdo lloj regjistri publik, lidhur me të dhënat për gjendjen gjyqësore, të dhënat për hyrje-daljet në kufi, regjistrin e të huajve, regjistrin e gjendjes civile, të dhënat për pasaportat dhe dokumentet e tjera të identifikimit, të dhënat për pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të çdo lloji, në të dhënat mbi të drejta ose interesa pasurorë të çdo lloji mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, regjistra të përqendruar të dhënash për kontrata dhe/ose detyrime të subjekteve private me organe të shtetit, regjistrat noterialë, regjistrin e pronarëve përfitues, regjistrin e llogarive bankare, të dhënat mbi automjetet dhe lejet e drejtimit, të dhënat tatimore dhe doganore, të dhënat mbi marrëdhënie të mundshme biznesi, veprimtari tregtare ose veprimtari të tjera profesionale.

Institucionet apo subjektet që disponojnë këto të dhëna janë të detyruara të bashkëpunojnë dhe të japin aksesin e kërkuar në informacion.

Për informacione e të dhëna të tjera, në bazat e të dhënave apo sistemet e klasifikuara “sekret shtetëror” mund të ketë akses, nëse ky veprim është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në marrëveshje me institucionin përkatës.

Mbledhja, përpunimi dhe administrimi i të dhënave u nënshtrohen rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi;

c) për qëllime të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, kërkon çdo lloj informacioni nga subjektet që i nënshtrohen këtij ligji.

ç) mbikëqyr përputhshmërinë e veprimtarisë së subjekteve me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përfshirë inspektimet në vend dhe në distancë, vetëm ose në bashkëpunim me autoritetet mbikëqyrëse;

d) shkëmben informacion me çdo agjenci të huaj homologe, në varësi të detyrimeve të ngjashme të konfidencialitetit. Informacioni i ofruar duhet të përdoret vetëm për qëllime të parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave e financimit të terrorizmit. Informacioni mund të shpërndahet vetëm me pëlqimin paraprak të palëve;

d/1) mund të refuzojë shkëmbimin e informacionit me agjencitë homologe të huaja vetëm në rrethana të jashtëzakonshme kur shkëmbimi vlerësohet se është në kundërshtim me parimet themelore të legjislacionit shqiptar.

dh) mund të hyjë në marrëveshje me çdo agjenci homologe të huaj, apo organizma të tjera jashtë vendit, që iu nënshtrohet detyrimeve të ngjashme të konfidencialitetit;

e) shkëmben informacion me prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, Prokurorinë e Posaçme, Policinë e Shtetit, Byronë Kombëtare të Hetimit, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe autoritetet e tjera kompetente të zbatimit të ligjit apo të inteligjencës, për çështjet e pastrimit të produkteve të veprës penale, veprat penale ose veprimtaritë kriminale që gjenerojnë produkte të veprës penale, financimit të terrorizmit, si dhe mund të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi dy ose shumëpalëshe me to;

e/1) mund të refuzojë kërkesat për informacion nga organet ligjzbatuese kur dhënia e informacionit:

i. cenon një hetim apo analizë të nisur;

ii. është qartazi jo në proporcion me interesat e ligjshme të një personi apo pa lidhje me qëllimin për të cilin është bërë kërkesa.

ë) mban statistika të plota dhe raporton për procedimet penale të regjistruara për veprat penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale dhe financimit të terrorizmit, si dhe për mënyrën e përfundimit të tyre;

f) kryesisht, mbi bazë të një vendimi të Këshillit të Ministrave, apo për rastet e kërkuara nga Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar, organizma të tjerë ndërkombëtarë, nga të cilët lindin detyrime për Republikën e Shqipërisë, nxjerr listë të vendeve për kufizimin dhe/ose kontrollin e transaksioneve apo marrëdhënieve të biznesit të subjekteve, proporcionalisht me rreziqet e evidentuara, vendime këto të detyrueshme për zbatim nga subjektet dhe autoritetet shtetërore që kanë detyrime sipas këtij ligji;

g) Urdhëron, kur ka arsye të bazuara në fakte dhe rrethana konkrete për pastrim parash, financim të terrorizmit apo financim të armëve të dëmtimit në masë, bllokimin ose ngrirjen e përkohshme të transaksionit ose të veprimit financiar për një periudhë jo më shumë se 72 orë. Brenda këtij afati, në qoftë se vëren elemente të veprës penale, autoriteti përgjegjës dërgon informacion në prokurori, duke dorëzuar edhe një kopje të urdhrit pezullimin e përkohshëm të transaksionit, ose për ngrirjen e llogarisë, sipas kësaj dispozite, si dhe të gjithë dokumentacionin përkatës. Pas kalimit të afatit 72-orësh nga nxjerrja e urdhrit, në mungesë të një vendimi për sekuestrim ose të një mase tjetër kufizuese të vendosur nga prokuroria ose gjykata kompetente, urdhri pushon së prodhuari efekte juridike;

g/1) mekanizmi i përcaktuar në shkronjën “g” të këtij neni, me të njëjtat kushte, mund të aplikohet edhe në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar;

gj) mban dhe administron të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin tjetër ligjor për 10 vjet nga data e marrjes së informacionit;

h) paraqet reagimet për raportimet që subjektet i bëjnë këtij autoriteti;

i) organizon dhe merr pjesë, së bashku me institucionet publike dhe private, në veprimtaritë trajnuese, për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, si dhe organizon ose merr pjesë në programe për të rritur ndërgjegjësimin e publikut;

j) njofton autoritetin përkatës mbikëqyrës, kur vëren se një subjekt nuk i përmbush detyrimet e përcaktuara në këtë ligj;

k) publikon brenda tremujorit të parë të çdo viti, raportin publik vjetor për vitin pararendës për veprimtarinë e autoritetit përgjegjës. Raporti duhet të përfshijë edhe statistika të hollësishme për origjinën e raporteve të marra dhe rezultatet e rasteve të parashtruara në prokurori;

l) urdhëron, kur ka arsye të bazuara për pastrim parash dhe financim terrorizmi, monitorimin, gjatë një periudhe të caktuar të veprimeve bankare që janë duke u kryer përmes një ose më shumë llogarish të përcaktuara;

ll) shfuqizuar;

ll/1) kryen edhe analiza strategjike brenda fushës së veprimtarisë së vet. Për këtë qëllim përdor të dhëna të disponueshme dhe kërkon statistika dhe të dhëna nga subjektet, autoritetet mbikëqyrëse dhe autoritetet e tjera kompetente, sipas nevojës.

Neni 22/1

### **Përdorimi i të dhënave**

*(shtuar me ligjin nr. 66/2012, datë 7.6.2012, shtuar një paragraf me ligjin nr. 44/2017, datë 6.4.2017; shtuar një paragraf pas paragrafit të parë me ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021; ndryshuar emërtim në fjalinë e parë dhe të dytë me ligjin nr. 62/2023, datë 21.7.2023)*

Çdo informacion apo e dhënë, e dërguar nga Agjencia e Inteligjencës Financiare për organet e zbatimit të ligjit, i nënshtrohet ligjit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror dhe nuk përbën provë në kuptimin e Kodit të Procedurës Penale.

Organet ligjzbatuese informojnë Agjencia e Inteligjencës Financiare për përdorimin e informacionit apo të dhënave të dërguara kryesisht nga kjo e fundit, si dhe për rezultatet e

hetimeve apo të inspektimeve të bazuara mbi të dhënat dhe informacionin e dërguar në mënyrë periodike çdo 6 (gjashtë) muaj.

Informacioni apo të dhënat e dërguara në zbatim të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” trajtohen në përputhje me parashikimet e atij ligji.

#### Neni 23

### **Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave**

*(ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 44/2017, datë 6.4.2017; ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019; ndryshuar pika 1, fjalia e parë e pikës 3, pika 4 dhe 5 me ligjin nr. 37/2026, datë 9.4.2026)*

1. Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave është përgjegjës për përcaktimin e drejtimeve të politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të armëve të dëmtimit në masë.

2. Komiteti drejtohet nga Kryeministri dhe në përbërje ka ministrin përgjegjës për financat, ministrin përgjegjës për punët e jashtme, ministrin përgjegjës për çështjet e mbrojtjes, ministrin përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, ministrin përgjegjës për çështjet e drejtësisë, Prokurorin e Përgjithshëm, Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Drejtorin e Shërbimit Informativ të Shtetit, Inspektorin e Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

3. Komiteti mbledhet të paktën 1 herë në vit për të shqyrtuar dhe analizuar raportet për veprimtaritë e kryera nga autoriteti përgjegjës, si dhe raportet për dokumentet e përgatitura nga institucionet dhe organizmat ndërkombëtarë, që ushtrojnë veprimtaritë e tyre në fushën e luftës kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të armëve të dëmtimit në masë. Drejtori i përgjithshëm i autoritetit përgjegjës i ofron komitetit, sipas kërkesës së tij dhe vepron si këshilltar në mbledhjet e këtij komiteti.

4. Në mbledhjet e komitetit mund të ftohen për të marrë pjesë ministra, deputetë, drejtues ose përfaqësues të institucioneve dhe ekspertë në fushën e parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të armëve të dëmtimit në masë.

5. Komiteti mund të krijojë grupe pune teknike dhe/ose operationale për të ndihmuar në kryerjen e funksioneve që ka, si dhe për studimin e tipologjive e të teknikave të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të armëve të dëmtimit në masë.

6. Rregullat e funksionimit të komitetit përcaktohen në rregulloren e brendshme, të miratuar nga ky komitet.

#### Neni 23/1

### **Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut**

*(Shtuar me ligjin nr. 37/2026, datë 9.4.2026)*

1. Institucionet anëtare të Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave, në përputhje me kompetencat e tyre ligjore, kontribuojnë në mënyrë periodike në vlerësimin e efektivitetit dhe frytshmërisë së sistemit kombëtar për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të

dëmtimit në masë nëpërmjet hartimit të Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut, si dhe planit përkatës të veprimit për zbutjen e rreziqeve të identifikuar.

2. Agjencia e Inteligjencës Financiare, në cilësinë e autoritetit përgjegjës, koordinon dhe bashkërendon procesin e hartimit të Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut dhe të planit të veprimit.

Për këtë qëllim, Agjencia e Inteligjencës Financiare ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë statistika, të dhëna dhe informacione nga:

- a) subjektet e këtij ligji;
- b) autoritetet mbikëqyrëse;
- c) organet e administratës shtetërore dhe bazat përkatëse të të dhënave shtetërore;
- ç) autoritetet e tjera kompetente të përfshira në parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të armëve të dëmtimit në masë.

3. Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut dhe plani përkatës i veprimit, i hartuar sipas pikës 2 të këtij neni, i paraqiten për miratim Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave nga Agjencia e Inteligjencës Financiare.

4. Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut rishikohet jo më pak se çdo 4 vjet.

5. Rezultatet e Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut u vihen në dispozicion organeve kompetente, në përputhje me funksionet e tyre, autoriteteve mbikëqyrëse dhe subjekteve të ligjit.

#### Neni 24

#### **Funksionet e autoriteteve mbikëqyrëse**

*(ndryshuar shkronja "b" e pikës 1, pika 2 dhe shtuar shkronja a/1 në pikën 4 me ligjin nr. 66/2012, datë 7.6.2012; zëvendësuar fjalë në pikën 1, shkronja "b", ndryshuar shkronja "i" dhe shfuqizuar shkronja "dh" e pikën 1, zëvendësuar fjalë në pikën 2; shtuar fjalë në pikën 4 shkronja "b" me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019, ndryshuar shkronja "dh" me ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021)*

1. Autoritete mbikëqyrëse janë:

a) Banka e Shqipërisë, për subjektet e përcaktuara, shkronjat nga "a", "b", "c", "ç" dhe "d" të nenit 3 të këtij ligji;

b) Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për subjektet e përcaktuara në shkronjat "e", "ë" dhe "j", të nenit 3, të këtij ligji;

c) ministritë dhe/ose autoritetet përkatëse për mbikëqyrjen e subjekteve të përcaktuara në shkronjat "f", "g", "gj", "h", "i", "k" dhe "l", të nenit 3, të këtij ligji;

ç) Dhoma Kombëtare e Avokatisë për avokatët;

d) Ministria e Drejtësisë për noterët;

dh) Bordi i Mbikëqyrjes Publike për audituesit ligjorë dhe kontabilistët e miratuar.

2. Autoritetet mbikëqyrëse mbikëqyrin, nëpërmjet inspektimeve, përputhshmërinë e veprimtarisë së subjekteve me detyrimet e parashikuara në këtë ligj. Për qëllimin e këtij ligji, pavarësisht nga parashikimet e ligjeve të tjera, autoritetet mbikëqyrëse mund të kërkojnë nga subjektet akses dhe vënien në dispozicion të çdo lloj informacioni dhe dokumenti që lidhet me përputhshmërinë e detyrimeve të subjekteve në zbatim të këtij ligji.

3. Autoritetet mbikëqyrëse i raportojnë menjëherë autoritetit përgjegjës çdo dyshim, informacion ose të dhënë, që lidhet me pastrim parash ose financim terrorizmi, për veprimtaritë nën juridiksionin e tyre.

4. Autoritetet mbikëqyrëse kryejnë edhe këto detyra:

a) kontrollojnë zbatimin e programeve të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nga subjektet dhe sigurohen se këto programe janë të përshtatshme;

a/1) informojnë në kohë dhe bashkëpunojnë me autoritetin përgjegjës, për çështjet e mospërputhshmërisë, rezultatet e inspektimeve të tyre, masat përmirësuese që do të merren dhe masat administrative, nëse ka pasur.

b) ndërmarrin masat e nevojshme për të parandaluar që një person i papërshtatshëm sipas përcaktimeve dhe kritereve të vendosura nga autoritetet mbikëqyrëse të zotërojnë, të kontrollojnë ose të marrë pjesë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në drejtimin, administrimin ose veprimtarinë e një subjekti;

c) bashkëpunojnë dhe të ofrojnë asistencë të specializuar, sipas veprimtarisë së tyre, në fushën e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, në përputhje me kërkesat e autoritetit përgjegjës;

ç) bashkëpunojnë për përgatitjen dhe shpërndarjen e programeve të trajnimit në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

d) mbajnë statistika për veprimet e ndërmarra, si dhe për sanksionet e vendosura në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

5. Autoritetet mbikëqyrëse përcaktohen saktësisht në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 24/1

### **Masa shitesë për vendet me risk të lartë**

*(shtuar me ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021)*

Autoritetet mbikëqyrëse dhe/ose licencuese zbatojnë një apo disa nga masat e mëposhtme në raport me vendet me rrezik të lartë:

a) refuzimi i themelimit të filialeve, degëve apo zyrave përfaqësuese të subjekteve nga vende me risk të lartë, ose në raste të tjera marrja në konsideratë e faktit se subjekti është nga një shtet, i cili nuk ka apo nuk zbaton sisteme të duhura për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

b) ndalimi i subjekteve që të themelojnë degë apo zyra përfaqësuese në vendin me risk të lartë apo marrja parasysh e faktit se dega apo zyra përfaqësuese përkatëse do të ishte në një vend i cili nuk ka apo nuk zbaton sisteme të duhura për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

c) të kërkohet mbikëqyrje e shtuar ose kërkesa të shtuara për auditim të jashtëm për degët dhe filialet e subjekteve që gjenden në vende me risk të lartë;

ç) të kërkohet shtimi i kërkesave për auditim të jashtëm për grupet financiare në raport me cilëndo prej degëve dhe filialeve të tyre që gjenden në vende me risk të lartë;

d) të kërkohet nga bankat ose institucionet financiare rishikimi dhe ndryshimi ose, nëse është e nevojshme, përfundimi i marrëdhënieve korrespondente me institucionet përkatëse në vendin/et me risk të lartë.

Neni 25

### **Moslejimi i spekulimit me sekretin profesional ose përfitimet prej tij**

*(shfuqizuar fjalia e parë e pikës 2 nr. 120/2021, datë 2.12.2021)*

1. Subjektet nuk duhet ta përdorin sekretin profesional ose përfitimet prej tij si arsye për mosrespektimin e detyrimeve, që rrjedhin nga ky ligj, kur kërkohet informacion ose kur, në përputhje me këtë ligj, urdhërohet nxjerrja e një dokumenti, që ka lidhje me informacionin.

2. Avokatët përjashtohen nga detyrimi për raportim, për të dhënat që i kanë mësuar nëpërmjet personit të mbrojtur ose të përfaqësuar prej tyre, në një proces gjyqësor, ose nga

dokumentet, që ky i fundit ua ka vënë në dispozicion, në funksion të mbrojtjes së kërkuar.

#### Neni 26

##### **Revokimi i licencës**

*(ndryshuar shkronja "b" e pikës 1 dhe shtuar pika 3 me ligjin nr.10 391, datë 3.3.2011)*

1. Autoriteti përgjegjës mund t'i kërkojë autoritetit licencues dhe/ose mbikëqyrës përkatës të kufizojë, të pezullojë ose të revokojë licencën e një subjekti:

a) kur konstaton ose ka fakte për të besuar se subjekti është përfshirë në pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit;

b) kur subjekti, në mënyrë të përsëritur, kryen njërën ose disa nga kundërvajtjet administrative të parashikuara në nenin 27 të këtij ligji.

2. Autoriteti licencues dhe/ose mbikëqyrës shqyrton kërkesën e autoritetit përgjegjës, bazuar në dokumentacionin shoqërues të saj, i cili paraqet të dhëna ose dyshime, të bazuara në rrethana dhe fakte konkrete, sipas pikës 1 të këtij neni. Autoriteti licencues dhe/ose mbikëqyrës vendos për pranimin ose refuzimin e saj, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tij dhe të subjekteve të licencuara dhe mbikëqyrura prej tij.

3. Në rastin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari bankare, në rrethanat e parashikuara nga shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij neni, autoriteti përgjegjës mund t'i kërkojë Bankës së Shqipërisë rritjen e shkallës së mbikëqyrjes së subjektit.

#### Neni 27

##### **Kundërvajtjet administrative**

*(ndryshuar pika 6, 11 dhe shtuar pika 12 me ligjin nr.10 391, datë 3.3.2011, ndryshuar me ligjin nr. 66/2012, datë 7.6.2012; ndryshuar pikat 1, 2 e 3, shfuqizuar pikat 4, 5, 6 e 7, zëvendësuar fjalë në pike 11 me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019; ndryshuar fjalë në shkronjat "d" e "dh, nënndarja "i" dhe shtuar shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 3 me ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021; ndryshuar pika 8, shtuar fjali pas fjalisë së dytë në pikën 10 me ligjin nr. 62/2023, datë 21.7.2023)*

1. Kur nuk përbëjnë vepër penale, shkeljet e dispozitave të këtij ligji përbëjnë kundërvajtje administrative dhe autoriteti përgjegjës vendos një ose disa masa administrative si më poshtë:

a) paralajmërim;

b) urdhër që detyron subjektin të ndalë një sjellje të caktuar, praktikë pune apo biznesi, si dhe të mos e përsërisë në të ardhmen;

c) urdhër për pezullim të përkohshëm apo zëvendësim të drejtuesve të strukturave përgjegjëse për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;

ç) gjobë;

d) shpallje publike të kundërvajtësit dhe natyrës së kundërvajtjes.

2. Për caktimin e llojit dhe masës së sanksioneve, sipas pikës 1, të këtij neni, përveç kritereve të vendosura në ligjin për kundërvajtjet administrative, merren parasysh edhe kriteret e mëposhtme:

a) fuqia financiare e personit juridik përgjegjës për shkeljen;

b) përfitimet që mund të ketë pasur subjekti që ka kryer shkeljen;

c) humbjet që mund të jenë shkaktuar ndaj palëve të treta për shkak të kryerjes së shkeljes (nëse ka pasur të tilla);

ç) niveli i bashkëpunimit i subjektit me autoritetet kompetente;

d) shkalla e përgjegjësisë së subjektit që ka kryer shkeljen.

3. Në rastet kur autoriteti përgjegjës vlerëson se për shkeljen e konstatuar duhet të vendoset gjobë, subjektet gjobiten si më poshtë:

a) për rastet kur nuk zbatohet detyrimet e parashikuara në ligj, si dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, për nenet 4, 4/1, pikat 1 e 1/1, 4/2, 5, 6 dhe 6/1, subjektet gjobiten nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë;

b) për rastet kur nuk zbatohet detyrimet e parashikuara në ligj, si dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, për nenet 7, pikat 1 dhe 2, 8, 9, 10, 11, 12, pika 3, 16 e 21/1, subjektet gjobiten nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 8 000 000 (tetë milionë) lekë;

c) për rastet kur nuk zbatohet detyrimet dhe afatet e parashikuara në ligj, si dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të këtij ligji, për raportim të aktivitetit të dyshimtë, të parashikuara në nenet 4/1, pika 2, 7, pika 3, dhe 12, pikat 1 dhe 2, subjektet gjobiten nga 300 000 (treqind mijë) lekë deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;

ç) për rastet kur nuk zbatohet detyrimet e parashikuara në nenin 3/1, organizimet gjobiten nga 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;

d) për rastet kur nuk zbatohet urdhrat, kërkesat dhe afatet e autoritetit përgjegjës, të nxjerra sipas dispozitave të këtij ligji, detyrimet e parashikuara në nenet 14 dhe 15, personat dhe/ose subjektet gjobiten nga 300 000 (treqind mijë) lekë deri në 20 000 000 (njëzet milionë) lekë;

dh) përveç sa parashikohet në pikat më sipër, kur subjekti është një person juridik dhe kundërvajtja administrative është kryer:

i) nga një punonjës jo në nivel të lartë dhe/ose administrimi, apo agjent, personi apo agjenti që ka kryer shkeljen gjobitet nga 20 000 (njëzet mijë) lekë deri në 300 000 (treqind mijë) lekë;

ii) nga një administrator ose drejtues i subjektit, personi që ka kryer shkeljen gjobitet nga 40 000 (dyzet mijë) lekë deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë.

e) për rastet kur shkeljet e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj, si dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij janë të rënda, të përsëritura, sistematike apo një kombinim i tyre, gjoba maksimale që mund të vendoset ndaj subjekteve është deri sa dyfishi i shumës së përfitimit të nxjerrë nga shkelja kur ai përfitim mund të përcaktohet ose deri në 125 000 000 (njëqind e njëzet e pesë milionë) lekë në rastet kur nuk mund të përcaktohet apo është më i vogël”.

ë) përveçse sa parashikohet në pikat më sipër, për rastet kur shkeljet e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj, si dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij kryhen nga subjektet e përcaktuara në nenin 3, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, kur:

i. subjekti është person juridik, vendoset gjobë deri në 10 (dhjetë) përqindëshin e qarkullimit total vjetor sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të vitit të fundit, të miratuara, ku përfshihen edhe pasqyrat financiare të bijave në rastet kur subjekti është një shoqëri mëmë. Në rast se 10 (dhjetë) përqindëshi i qarkullimit total vjetor është më pak se 625 000 000 (gjashtëqind e njëzet e pesë milionë) lekë, nga autoriteti përgjegjës vendoset gjoba deri në 625 000 000 (gjashtëqind e njëzet e pesë milionë) lekë;

ii. subjekti është person fizik vendoset gjoba deri në 625 000 000 (gjashtëqind e njëzet e pesë milionë) lekë.

4. Shfuqizuar.

5. Shfuqizuar.

6. Shfuqizuar.

7. Shfuqizuar.

8. Masat administrative përcaktohen dhe vendosen nga Agjencia e Inteligjencës Financiare.

9. Autoriteti përgjegjës informon autoritetet licencuese dhe/ose mbikëqyrëse për sanksionet e vendosura.

10. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim procedurat e konstatimit, të shqyrtimit, të propozimit dhe të vendosjes së masave administrative nga autoriteti përgjegjës. Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të gjobave, të vendosura me vendim të autoritetit përgjegjës, bëhen në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. Masa e kamatëvonesës për gjobat e vendosura nuk mund të kalojë vlerën e gjobës.

11. E drejta për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, të parashikuara në këtë nen, nuk mund të ushtrohet kur kanë kaluar 5 vjet nga çasti i kryerjes së kundërvajtjes administrative.

#### Neni 28

##### **Nxjerrja e akteve normative**

*(Zëvendësuar fjalë në pikën 1, shfuqizuar shkronja “d” në pikën 3 me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019; ndryshuar shkronja “a” e pikës 3 me ligjin nr. 120/2021, datë 2.12.2021)*

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr rregulla të hollësishme për formën, mënyrën dhe procedurën raportuese të të dhënave, në zbatim të këtij ligji, për autoritetet licencuese dhe ato mbikëqyrëse, Agjencinë Shtetërore e Kadastrës.

2. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive i paraqet periodikisht dhe jo më pak se dy herë në vit, autoritetit përgjegjës listën e plotë dhe të përditësuar të personave të ekspozuar politikisht, të hartuar sipas parashikimeve të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

3. Ministri i Financave, me propozimin e autoritetit përgjegjës, nxjerr, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, rregulla të hollësishme për:

a) mënyrat dhe procedurat për zbatimin nga subjektet raportuese të detyrimeve të parashikuara në këtë ligj;

b) mënyrat dhe procedurat për raportimin nga organet doganore;

c) mënyrat dhe procedurat për raportimin nga organet tatimore;

ç) shfuqizuar;

d) shfuqizuar.

#### Neni 29

##### **Dispozita kalimtare**

*(shtuar dy paragrafë me ligjin nr. 62/2023, datë 21.7.2023)*

Deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji do të zbatohen dispozitat e ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”, të ndryshuar.

Të gjitha aktet nënligjore, të dala në zbatim të ligjit nr.8610, zbatohen për aq sa ato nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, deri në zëvendësimin e tyre me akte të tjera nënligjore, që do të dalin në zbatim të këtij ligji.

Ndryshimi i emërimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave në Agjencinë e Inteligjencës Financiare nuk cenon të drejtat dhe funksionet e strukturës, si dhe realizohet në përputhje edhe me detyrimet për bashkëpunim kombëtar dhe ndërkombëtar.

Të gjitha aktet nënligjore, përfshirë marrëveshjet e bashkëpunimit me struktura brenda dhe jashtë vendit, të nënshkuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, në zbatim të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, zbatohen deri në zëvendësimin e tyre me akte të tjera në zbatim të këtij ligji.

Neni 30

### **Dispozitë shfuqizuese**

Ligji nr. 8610, datë 17.5.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 31

### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 5746, datë 9.6.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi.**